

Buxheti me pjesëmarrje

Sot vendos edhe ti!

Lexoni në faqen 3



Në foto: Nga ceremonia e 15 vjetorit të gazetës "NOSITI"

Aktualitet

Pogradec: Prezantohet Plani Rregullues



Lexoni në faqen 4

Letërsi

Pak dritë, për librin Ringjallet Rilindja e Lasgushit!

Personalitete të tjerë të shquar e kanë cilësuar si princ të poezisë shqiptare, që po të kishte shkruar në Francë do të ishte i përmasave të Bodlerit e Malarmesë...

Lexoni në faqet 11-12-13

Media

Idealistët i bëjnë ca gjëra që s'i bën njeri

Nga Afroviti Gusho

Menduar se i ftuar të gjithë në festën e Nositit, por u gabuar. Edhe pse printuar 1000 ftesa, i shpërndamë ngado në Pogradec, pastaj dërguar dhjetëra e-maile, pastaj kërkua "ndihmë" në FaceBook (a s'është në modë FB?!), pastaj dërguar njoftime e spote në TV lokale, pastaj...

Lexoni në faqen 7

15 vjet NOSITI

Urime, mesazhe



Lexoni në faqet 8-9

15 vjet NOSITI

Fituesit e konkursit me rastin e 15-vjetorit të gazetës "Nositi"



Lexoni në faqen 9



BANKA POPULLORE

SOCIETE GENERALE GROUP

LSI e Korçës sherr me Bashkinë për festën e çlirimit

Festimi i 65-vjetorit të çlirimit të qytetit të Korçës fut në sherr LSI-në me Bashkinë. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast LSI-së nuk i kish shkuar ftesë nga Bashkia. “Nuk është një festë lakrori apo birre, por një festë e të gjithëve” – u shpreh në deklaratën e saj zëdhënësja e LSI-së për Korçën Arsidea Hysi. Në të njëjtën kohë ka reaguar Bashkia nëpërmjet zëdhënësës së saj se antarë të LSI-

së kanë qenë në ceremoni dhe ne nuk mund t’u bëjmë ftesë të gjithë fraksioneve që ka në këtë parti. Por përsëri zëdhënësja e LSI-së Hysi ka dalë në konferencë shtypi ku ka sulmuar Bashkinë duke u shprehur: “Epidemia Rama -Legisi është shfaqur edhe në Bashkinë e Korçës. Nuk ka fraksione në partinë tonë. Zëdhënësja e Bashkisë nuk di se ku janë zyrat tona. Nuk përjashtojmë rastin që kjo

zëdhënësja njih anëtarë të LSI-së dhe mund të kenë qenë në sallën e ceremonisë. Por këta individë nuk përfaqësojnë LSI-në, por përdoren nga Bashkia në dobi të interesave të saja, si bënë në Tiranë Rama me Legisin.”

Në Bashkinë e Korçës qëndron ende nënkryetar një përfaqësues i LSI-së, Arjan Bejko. Por zëdhënësja nuk dha sqarime për praninë e tij ende në këtë detyrë,

kur këshilltarët e LSI-së i janë ngjitur grupit të këshilltarëve të djathtë.

Megjithatë festa e çlirimit të qytetit fut në sherr LSI-në me Bashkinë që drejtohet nga socialisti Niko Peleshi. Flitet se Peleshi mund të kalojë në të ardhmen me LSI-në, ose me ndonjë parti tjetër që ai e ka patur përzemër, nëse e pranojnë.

P.Çuni

SEMINAR

Me pjesëmarrje të gjerë të juristëve, përfaqësues dhe drejtues të institucioneve shtetërore, përfaqësues nga biznesi dhe mediat lokale në ambientet e Hotel-Bar-Restorant “1 Maji” më 15 tetor 2009 u zhvillua seminari me temë: “Njohja me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe autoritetin mbikqyrës”. Ky aktivitet u organizua nga Komisioneri Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me qendër në Tiranë, me Komisioner zonjën Flora Çabej.

Pas fjalës së hapjes nga zonja Çabej, fjalën e mori për të referuar dhe shpjeguar për të pranishmit në mënyrë të detajuar, konkrete dhe të kuptueshme eksperti i BE pranë këtij institucioni, zoti Karel Neuwirt. Referuesi, ndër të tjera, solli përvojën europjane dhe atë botërore në të gjitha aspektet që parashikon ligji. Objekt i këtij seminari ishte

zberthimi, kuptimi, vlerësimi dhe interpretimi i ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008.

Për “Hartimin e këtij ligji- Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale-Rregullat për përpunimin e të dhënave” referoi zonja Anola Shala, Drejtore e Drejtorisë ÇLMJ.

Ndërsa për “Detyrat e kontrolluesit dhe të përpunuesit, të drejtat e subjektit të të dhënave personale” i referoi zonja Mirela Hila, Drejtore e Drejtorisë së Hetimit dhe Inspektimit. “Autoriteti mbikqyrës, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” referoi zoti Agim Gjoleka, këshilltar pranë komisionerit.

Në të gjithë përmbajtjen e këtij seminari u evidentuan probleme shumë serioze për të gjithë shoqërinë, institucionet dhe individin në kushtet e sotme të zhvillimit të madh të teknologjisë së informacionit, kujdesi i të gjithëve me të dhënat dhe përpunimi i tyre nga autoritetet. Sot po përdoren gjerësisht rrjetet sociale (facebook). Problem përbën vjedhja e identitetit.

Njerëzit duhet të dinë dhe të kuptojnë se kush ka të drejtë të marrë të dhëna personale, masa e tyre, koha dhe përdorimi dhe duhet ta dinë se tani ka një institucion shtetëror, që është: Komisioneri Për

Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (The Commissioner for personal data protection), ku mund të drejtohesh nëse ato keqpërdoren. Ky ligj respekton dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtën e ruajtjes së jetës private.

Të dhënat mund të jenë personale fizike, por edhe sensitive (shëndeti, bindjet, besimi, raca, anëtarësia në sindikata, dënimet penale e të tjera).

Në seminar u theksua ndërgjegjësimi i popullsisë për këtë problem kaq të rëndësishëm në kushtet e reja të informacionit masiv dhe dixhitalizimit.

Njohje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

Fiton azilin e pleqërisë pas vdekjes

Që në muajin mars një i moshuar kishte bërë kërkesë për t’u sistemuar në një azil pleqsh, por përgjigja nga Ministria i vjen pas vdekjes, se ai e kishte fituar të drejtën për t’u bërë banor i një azili.

Në qytetin e Korçës nga vetë ndryshimet social-ekonomike gjenden shumë pleq të vetmuar që kanë nevojë për shërbime të veçanta, pasi nuk mund t’i shërbejnë dot vetes së tyre. Nga disa të dhëna thuhet se janë 1500 pleq që jetojnë të vetmuar pa praninë e fëmijëve. Mund të jenë çift, por ka dhe të mbetur vetëm.

Dikur në qytetin e Korçës ka

patur një azil të pleqve, i cili mblidhte të moshuarit e moshës së tretë që nuk kishin kushte për të kaluar ditët e fundit në banesat e tyre.

Kjo mund të vinte nga braktisja e fëmijëve ose nga mungesa e të afërmeve të tjerë për t’u dhënë ndihmë dhe përkrahje. Po azili i Korçës ka 20 vjet që nuk funksionon më. Kështu që pleqtë që kërkojnë azil, bëjnë dokumentat dhe vendosen në rezidencat jashtë Korçës.

Që nga muaji mars në këshillin e Bashkisë së Korçës u është miratuar e drejta për të qenë pjesë e një rezidence 6 personave të

moshës së tretë. Nga këta persona vetëm njëri ka marrë përgjigje pozitive, por... personi që përfitoi të drejtën për në azil, kur i erdhi përgjigja kishte ndërruar jetë.

Për të fituar një azil pleqërie është një procedurë e gjatë dhe e lodhshme. Nis me një kërkesë pranë bashkisë.

Miratohet në Këshillin Bashkiak, pastaj përcillet në Ministrinë e Punës dhe çështjeve Sociale. Ka disa ura të ndërmjetme për ta fituar atë, por mund ta marrësh edhe pas vdekjes si rasti i të moshuarit nga Korça.

P.Çuni



Bashkia Pogradec

Nëse dy tre vite më parë bashkia e qytetit dhe stafi i saj drejtues ka tentuar të hartojë dhe të miratojë një buxhet vjetor me pjesëmarrje të komunitetit, rezultatet nuk kanë qenë ato të kërkuara dhe të planifikuara. Këtë theksoi, midis të tjerash, në takimet e organizuara me komunitetin kryetari i kësaj bashkie, zoti Artan Shkëmbi në tre zonat e planifikuara për pjesëmarrjen dhe mendimin qytetar. Të rinj e të reja, aktivistë të shoqatës "Unë Gruaja"-Pogradec u shpërndanë pjesëmarrësve një thirrje, në të cilën u shpjegonin qytetarëve Nenin 35 të Ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Pushtetit Lokal" si dhe Ligjin 8503, datë 30.06.1999 "Për të Drejtën e Informimit", me synimin që komuniteti të kuptojë se pjesëmarrja e tij është domosdoshmëri, por edhe një e drejtë e garantuar me ligj.

Salla e Teatrit të Kukullave "Pirro Xëci" më datën 27 tetor 2009 ishte e mbushur me qytetarë të ndryshëm nga lagja nr.2, punonjës të aparatit të Bashkisë dhe të institucioneve të tjera në qytet.

Zonja Lindita Oshafi, moderatore dhe përfaqësuese e Institutit të Kërkimeve Urbane Tiranë, duke falënderuar pjesëmarrësit për vlerësimin, që i kanë bërë ftesës për të marrë pjesë në këtë takim shumë të rëndësishëm, foli për etapat që do të ndjekë hartimi dhe miratimi i Buxhetit 2010 me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të komunitetit.

Ai do të shprehë shqetësimet, nevojat dhe kërkesat sipas zonave dhe lagjeve, rrugën, që do të ndiqet deri në realizimin e atyre prioriteteve. Këto janë rezultat i një bashkëpunimi dhe interesimi direkt i Bashkisë, konkretisht i zotit Shkëmbi.

Për ta bërë sa më të qartë dhe më konkret për komunitetin zoti Shkëmbi solli shembullin e një familje, që planifikon sipas dëshirave të anëtarëve të saj dhe mbi bazën e të ardhurave reale realizon ato, që janë më të domosdoshme, kështu do të mendohet dhe vepohet edhe për qytetin.

Nga diskutimet evidentohet më shumë infrastruktura, pastrimi i qytetit, disproporcioni me qendrën e qytetit, ndotja e ajrit nga pluhuri, djegia e plehrave, shqetësimi nga qentë, ujrati e ndotura mbi asfalt, pastrimi i Lumit të Madh dhe Lumi i Vërdovës. Në disa rrugica u shtrua kërkesa për ndriçim më të plotë.

Ky është vetëm fillimi i një procesi të

-buxheti 2010 përballë qytetarëve



Pjesëmarrja qytetare

Sot vendos edhe ti!

ri, që në vitet që do të vijnë duhet të kthehet në një standart për institucionin e Bashkisë, komuniteti të rritë çdo vit e më shumë ndërgjegjësimin për t'u bërë partner aktiv në këtë proces dhe duhet të kuptojë se ka rol parësor vendimmarrës, rrit gjithnjë e më shumë transparencën.

Dy ditë më vonë, më 29.10.2009 salla kryesore e Qendrës Kulturore "Lasgush Poradeci" ishte takimi i dytë me komunitetin e zonës tjetër për të diskutuar dhe për të dëgjuar zërin e qytetarëve për kërkesat dhe nevojat që ata i shohin dhe i vlerësojnë si të domosdoshme të zgjidhen nga Bashkia në plan-buxhetin 2010.

Në takim u theksua se komuniteti nëpërmjet përfaqësuesve të vet do të ndjekë nga afër dhe konkretisht do të mbrojnë para Këshillit Bashkiak prioritetet përfundimtare, të cilat të merren në konsiderat dhe të planifikohen për t'u realizuar nga bashkia.

Përfaqësuesit do të jenë monitorues të rregullt deri në realizimin përfundimtar. Kështu ata edhe do të raportojnë për performancën e Bashkisë në këtë aspekt. Ndryshe nga takimi i parë, u vu re se pjesëmarrja qytetare ishte jo në nivelin e duhur dhe se kryesisht shumicën e përbërësve administrata. Kjo

la për të dëshiruar dhe për të diskutuar. U la të kuptohet se diçka çalonte, diçka nuk ishte vlerësuar si duhej: lajmërimi qytetar. Nga organizatorët dhe drejtuesit e këtyre takimeve u deklarua se një pjesë jo e vogël e komunitetit shpreh njëfarë indiferentizmi ndaj këtyre aktiviteteve.

U hodh ideja për ta riparë mënyrën e organizimit, të lajmërimit dhe të sqarimit qytetar. Mbase në këto takime, por më konkretisht Bashkia duhet të gjejë burimin e këtij indiferentizmi, të gjejë pse-në. Ky është vetëm fillimi. Si në takimin e parë edhe këtu u ndoqën të njëjtat procedura prezantimi për qëllimin e takimit.

Takimi i dytë përfshinte sipas planit Bllokun Rinia-Lumi i Qytetit. Kryetari Bashkisë, zoti Shkëmbi shpjegoi në detaje se çfarë është bërë, çfarë është në proces dhe çfarë është në plan për t'u bërë.

Nga të gjithë ata që e morën fjalën, u sollën një sërë shqetësimesh:

Duhen investime më të kujdesshme dhe më të përgjegjshme në varrezat e reja të Zagorçanit. Për të krijuar kushtet më të mira, u kërkuar të parashikohet një shtesë në shkollën "Kolë Koci", ndërsa për shkollën "Gjok Shqiptari" të shihet mundësia e kufizimit të qytetarëve, pasi atje është me shumë porta, duke krijuar probleme të ndryshme për

procesin mësimor, por ndoshta edhe me karakter social.

Rikonstrukcioni i Odeonit Kulturor të qytetit, për t'u bërë më i plotë e me një kapacitet më të madh. Të shihet konkretisht ç'mund të bëhet më tej për pushimin dhe argëtimin e pensionistëve, ishte mendimi i një qytetari. U kërkuar zgjidhje për dy objektet e dëmtuara të ish-Turizmit dhe "Oktapodit", edhe nga pikëpamja higjienike, por edhe turistike stonojnë shumë me ndryshimet në qytet. Të shihet mundësia e vendosjes së semaforëve ishte një mendim tjetër.

Takimi i organizuar në ambientet e shkollës "30-vjetori" më datën 30.10.2009 ishte përmblyllës në kuadër të tre takimeve të planifikuara, ku Bashkia e qytetit në bashkëpunim me Institutin e Kërkimeve Urbane Tiranë u krijoi hapësira reale banorëve të saj për të qenë realisht pjesë aktive e iniciativës "Buxhetimi me pjesëmarrjen e komunitetit" me moton: "Sot vendos dhe ti".

Ndryshe nga dy takimet e para, në këtë takim binte në sy një pjesëmarrje më e gjerë e komunitetit: burra, gra, të rinj. Prezantimi i thjeshtë dhe i kuptueshëm nga moderatorja L.Oshafi, krijoi një atmosferë mirëkuptimi dhe i nxiti ata të merrnin pjesë lirish në diskutime të lira dhe konkrete. Në këtë takim ndodheshin kryetari i Bashkisë zoti A.Shkëmbi, zëvendëskryetarët Erion Vesho, Vilson Maku, gjithashtu dhe drejtorët e drejtorive të Bashkisë. Edhe kësaj radhe shumë diskutantë nuk munguan të vlerësojnë punën e mirë që ka bërë dhe vazhdon të bëjë Bashkia e qytetit.

U kërkuar të shihet mundësia për një kënd sportiv, por të plotësohet me të gjitha veglat dhe kushtet e nevojshme. U diskutua dhe u sqarua shqetësimi për ish pallatet e minierës së Gurit të Kuq. Ura e gurtë e lumit të qytetit që shërben për lidhjen e të dy lagjeve të jetë më funksionale, u kërkuar nga një tjetër diskutant. Problemi i Lumit të Madh të qytetit, papastërtia e tij, ku një pjesë jo të vogël të përgjegjësisë e mori komuniteti. Tani në lumë punohet dhe e ardhmja do të jetë më e mirë.

Krijimi i disa rrugëve në kala për lidhjen e disa familjeve me pjesën tjetër të qytetit ishte një problem tjetër shqetësues.

Edhe nga ky takim u caktuan prioritetet dhe u zgjodhën përfaqësues nga komuniteti për të monitoruar në vazhdimësi.

Dh.Gegprifti

Shumë pak pyetje e shumë pak përgjigje

Indiferentizëm dhe papërgjegjshmëri

U zhvillua mbledhja e këshillit bashkiak të Pogradecit. Mbledhja filloi me një propozim nga zoti Gjergji Ilo, kryetar i Këshillit Bashkiak: -Të kalojë në fund pika e parë e rendit të ditës "Analiza ekonomiko-financiare për 6-mujorin e parë 2009"! Propozimi nuk u miratua dhe procedua sipas rendit të ditës.

Konformizëm apo vlerësim real...?

Edhe vetë këshilltarët në biseda të lira u shprehën për një farë formaliteti, që sipas tyre nuk është dukuri e rastit, por edhe e përsëritur. Industrialisti, Filantropi shqiptaro-amerikani Peter Kole; kësaj radhe vinte me propozim të kryetarit të Bashkisë, zotit Artan Shkëmbi për t'u bërë qytetar nderi.

Administrata, që ishte shumë pak nga pikëpamja numerike, shumë shpejt i la karriket bosh, sikur nuk kish të bënte me themeloret: me të ardhurat dhe shpenzimet si elementë të buxhetit pa të cilin nuk funksionon asgjë.

Edhe raportimi i Komisionit të Ekonomi-Financës sipas nesh ishte shumë i përciptë, pa hyrë në hollësi, pa nxjerrë shkaqe për mosrealizime apo realizime, për pasojë dhe pa kërkuar llogari. Kjo mbase solli atë "indiferentizëm dhe papërgjegjshmëri..." të të gjithë këtij këshilli, për të cilin nuk mungoi dhe reagimi i menjëhershëm i një këshilltari të Partisë Socialiste.

Shumë pak pyetje e shumë pak përgjigje. S' kish si të ndodhte ndryshe. Pas kësaj erdhi dhe miratimi. Por nuk dëgjuam dhe mësuam se çfarë u miratua, çfarë nuk u miratua dhe çfarë u sugjerua për të ardhmen! Atë e miratuan me ngritjen e kartonave. Si zakonisht u kalua në miratimin e 9 projekt-vendimeve, nga të cilët vetëm për njërin u tentua të pyetjet e të diskutohesh: "Projektvendimi për miratim liste "i pastrehë" në ish-pronë private. Janë listuar 57 familje. U kërkuar sqarime si duhet kuptuar dhe kategorizuar, u

dhënë dyshime se ka nga ata që s'duhet të futen në këtë listë, se mund të përfitojnë padrejtësisht. Por u miratua edhe ai si gjithë të tjerët.

Reagimi...

Tashmë koha dhe përvoja na kanë mësuar se mosmiratimi i Buxhetit në institucionet qendrore apo lokale shpie deri në rënie të qeverisë qendrore apo lokale. Në vazhdim të kësaj pasaje, do të rreshtojmë jo më pak të rëndësishme edhe analizat ekonomiko-financiare të niveleve të ndryshme, ku për fat të keq, megjithë sugjerimet, kërkesat, rekomandimet, debatet, vazhdon të ndiqet e njëjta procedurë. Këshilltarëve u jepën disa faqe me statistika shifrash, duke menduar se Këshilli është institucion statistike. Këshilltarët dhe qytetarët duan të dinë se si janë mbledhur dhe pse s'janë realizuar të ardhurat, duan shkaqet dhe pasojat, duan të dinë se kush e ka përgjegjësinë dhe çfarë do të bëhet në të ardhmen.

Mjafton të sjellim disa fakte: Nga rreth 46 zëra, vetëm për 11 tentohet të thuhet diçka dhe kjo shumë telegrafike, ndërsa në tabelën e shpenzimeve nga rreth 34 zëra tentohet për 3. Të njëjtën gjë edhe për Ndërmarrjen e Gjellbërimit e të Ndrçimit, Punëve Publike, Sektorin e Arsimit, Klubin Shumësportësh (vetëm plani i shpenzimeve dhe fakti), Qendra kulturore "Lasgush Poradeci", realizimi i investimeve. Kjo përgjegjësi dhe vështirësi të tyre nuk janë të pranishme askund, por nuk janë as edhe detyrat e institucioneve veçmas Bashki e të tjera. Na lindin dy pyetje: Nëse kjo analizë do të bëhet e ndarë, me këtë material do të paraqiteshin?!... Këshilli Bashkiak si e vlerëson një analizë të tillë, si e miraton?! Këshilli e di se analiza e 6-mujorit të dytë miratohet pa analizë, vetëm si miratim faktik dhe kalohet në miratimin e Buxhetit për vitin pasardhës. Kjo, nga praktika e deritanishme.

Dh.Gegprifti

POGRAD EC

Prezantohet Plani Rregullues

Në dy takime rresht, në datat 8 dhe 9 tetor 2009 Bashkia Pogradec, në sallën e hotel "Enkelana", në bashkëpunim me Institutin e Projektmeve të Republikës, organizoi takimin për diskutim të Draftit të Planit Rregullues të qytetit të Pogradecit.

Organizatorët e kishin planifikuar këtë prezantim dhe diskutim me dy takime: në të parin ky draft-plan u diskutua me të gjitha grupet e interesit të qytetit, qytetarë, përfaqësues shoqatash, ndërsa takimi i dytë me përfaqësues institucionesh, qytetarë, këshilltarë, ekspertë të fushës, por edhe të fushave të tjera. Në të dy takimet ishte i pranishëm kryetari i kësaj Bashkie, zoti Artan Shkëmbi, i cili, jo vetëm prezantoi qëllimet dhe rëndësinë e këtyre takimeve, por edhe procedurat e ndjekura deri në këtë fazë dhe bashkëpunimin me Institutin. Ky draft-plan pas këtij prezantimi, pyetjesh, diskutimesh dhe sugjerimesh, do të diskutohet edhe në KRRT e Bashkisë dhe mandej do të dërgohet në KRRTSH.

Prezantimi

Kryetarja e këtij grupi projektimi,

zonja Fatlinda Struga u shpjegoi pjesëmarrësve se ky draft-plan mbështetet në detyrën e projektimit të vitit 2003, nga e cila jemi orientuar. Ky projekt-plan parashikon një periudhë kohore 15-20 vjet.

Lartësia e ndërtesave nuk do të merret ajo e vitit 2003, por kjo ekzistuese, duke mos kaluar nga 7 kate, me pamje të një amfiteatri nga liqeni në drejtim të kalasë. Mbahen parasysh akset e reja nacionale të miratuara Qafë-Thanë - Qafë-Ploçë dhe mundësitë e reja të zhvillimit të qytetit dhe të fshatrave përreth.

Të trija skemat e zhvillimit urban mbështeteshin në zhvillimet dhe ndryshimet demografike: me 50.000 banorë, 60.000 dhe 78.000. Më e mundshme mbetet skema me 60.000 banorë. Qyteti tani dhe në të ardhmen do të jetë i grupuar në 13 zona: zonat e banimit, zona e Liqenit, e cila mendohet se do të jetë polifunkionale, ish-zona ekonomike mendohet të ndryshojë, pasi e ka humbur funksionin, të bëhet zonë banimi me ndërtesa sociale. Zona shtetërore-sociale do të qëndrojë, zona sportive do të qëndrojë dhe do të plotësohet me zonë të gjelbër. Do të



qendrojnë zona Muze, zonat e pushimit në breg të liqenit. Zona e varrezave nuk do të vazhdojë më të zgjerohet, por do të gjelbërohet. Do të ngelet zona e varrezave të Dëshmorëve, po ashtu zona shëndetsore. Të shikohet zona e re ekonomike, që do të lidhet me pikat hyrëse nga Vërdova, duke u lidhur me breza gjelbërimit. Zona e fshatrave do të kenë mundësi për lidhje me qytetin dhe anasjelltas. E tillë parashikohet të ngelet zona rezidenciale.

Mendimi dhe shqetësimi qytetar

A është marrë në konsideratë bulevardin Lin-Tushemisht? A do të merren në konsideratë si popullsi rezidente ata që kanë blerë, por që nuk jetojnë gjithë kohën këtu?

A do të jemi të sigurt se do të

ndërtohet njëri nga këto variante (akset nacionale), pasi po ndërtohet rruga Qafë-Ploçë -Qukës? Çfarë do të ketë zona elitare turistike? Si është parë dhe çfarë është parashikuar në Kala? A do të ketë park lojrash në zonën rekreative?

Sa është sipërfaqja e vijës së verdhë dhe sa do të vejë? Sa është aktualisht zona e banimit? (sot 200 ha, nëse shkon 50.000 banorë 315 ha dhe me 60.000 banorë -350 ha). A ka zona që nuk funksionojnë si duhet? A mendohet për një distrikt artistik, për një zonë arti, duke e kthyer Pogradecin në një qytet europian? Me falënderimin për pjesëmarrjen e gjerë, pyetje dhe diskutime me interes, falënderimin për grupin e projektimit, zoti Shkëmbi mbylli aktivitetin.

Promovohet Rrjeti i Grave "Barazi në Vendimmarrje"

Të luftojmë për të qenë të barabarta me burrat

Me iniciativën e një grupi grash, pjesë e programit të NDI "Zhvillimi i Liderve në Politikë – Gratë në Advokim" të të gjitha partive nga e gjithë Shqipëria, është formuar Rrjeti i Grave "Barazi në Vendimmarrje". Qëllimi i këtij rrjeti është rritja e rolit të gruas në vendimmarrje kurse objektivat: shtrirja e rrjetit në të gjitha qytetet, evidentimi i vlerave, përkrahja e tyre, forcimi organizativ i të gjitha strukturave, presion ndaj subjekteve politike për të mbushur kontratën 30% në zgjedhjet e pushtetit vendor.

Rrjeti i grave "Barazi në vendimmarrje" aspiron për një shoqëri demokratike dhe të civilizuar nëpërmjet shanseve të barabarta për të gjithë dhe i ka vënë vetes misionin për promovimin dhe rritjen e përfaqësimit të gruas deri 30% në prag të zgjedhjeve vendore

në Shqipëri në vitin 2011.

Promovimi i rrjetit u bë për qarkun e Korçës më 13 tetor 2009 në Grand Hotel në Korçë.

U ftuan për të marrë pjesë në këtë aktivitet: drejtues të Bashkive, të Qarkut, kryetarë të partive politike të majta, të djathta dhe të partive të koalicionëve, drejtues të institucioneve civile, përfaqësues të shoqërisë civile, gra në vendimmarrje, gra me kontribute në jetën politike dhe mediat lokale dhe qendrore. Ra në sy se në promovim të gjithë burrat e ftuar ishin përfaqësuar me gra të institucioneve respektive.

Rrjeti u bëri thirrje vajzave dhe grave që ndjehen të gatshme të kontribuojnë në politikë, t'i bashkohen rrjetit të grave "Barazi në vendimmarrje" sepse së bashku mund të identifikojnë vlerat, do të



bëhen të dukshme, do t'u dëgjohe zëri, do të kenë mundësi të jenë pjesë e vendimmarrjeve të rëndësishme për të ardhmen e fëmijëve. "Ne duhet të jemi bashkë dhe shumë, u theksua në thirrje, sepse një zinxhir i gjatë reziston më shumë ndaj "këputjeve". Rrjeti është i ngritur në Pogradec, janë zhvilluar edhe trajnime por ky le të jetë vetëm një fillimi i një lëvizjeje që do të rritet. Mendojmë që jemi në kohë për të marrë në dorë situatën politike për ta përgatitur atë

në favorin tonë. Të gjitha së bashku pa dallim politik duhet të luftojmë për të bërë më të mirën në zgjedhjet e vitit 2011. Ju mund të bëni propozime për projekte që do ta bëjnë më të gjallë jetën politike në qytet (ku edhe burrat do të jenë aktorë), mund të tregoni sa mirë dini të drejtoni projekte, kjo do të jetë njëra nga provat, për të thënë që mund t'ia dalim edhe për të drejtuar institucione."

Lindita Ibrahim

Bashkëpunimi ndërkuftar

-në kuadër të politikave rajonale dhe zhvillimit të integruar rural

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN) dhe Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) të mbështetur nga Open Society Foundation for Albania, Soros Foundation në ambientet e hotel-restorant "Millenium" në Tushemisht të Pogradecit më 26 tetor 2009 zhvilluan konferencën rajonale me temë "Bashkëpunimi ndërkuftar në kuadër të politikave rajonale dhe zhvillimit të integruar rural -Fokus qarku i Korçës".

Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin përfaqësues nga Këshilli i Qarkut Korçë dhe të rrethit të Pogradecit, institucione qendrore në nivel vendor, shoqëria civile lokale, përfaqësues institucionesh, si dhe të grupit të interesit nga Shqipëria dhe Maqedonia.

Konferenca në tërë aktivitetin e saj synoi informimin dhe

ndërgjegjësimin e përfaqësuesve të grupeve të interesuara mbi mundësitë dhe sfidat e bashkëpunimit ndërkuftar, avantazhet e këtij instrumenti në kuadër të hartimit dhe zbatimit të politikave rajonale dhe zhvillimit të integruar rural.

Promovimi i gjetjeve të studimit të zhvilluar nga IDN dhe EMA mbi mundësitë e bashkëpunimit ndërkuftar për qarkun e Korçës ishte një synim tjetër i kësaj konference.

Pas fjalës falënderuese të hapjes, prezantimit të organizatorëve dhe të pjesëmarrësve u referuan materialet e shoqëruara në monitor:

"Prezantimi i gjetjeve të studimit: bashkëpunimi ndërkuftar në kuadër të politikave rajonale dhe zhvillimit të integruar rural" u referua nga znj. Erisa Çela, Departamenti i

Qeverisjes Vendore dhe Zhvillimit të Integruar.

Gledis Gjipali dhe Grigor Gjeci respektivisht Drejtor Ekzekutiv EMA dhe Drejtor i Zhvillimit të Politikave Rurale, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrotjes së Konsumatorit referuan përkatësisht: Programet e Bashkëpunimit Ndërkuftar në Qarkun e Korçës dhe Zhvillimi rural në vend dhe Bashkëpunimi Rajonal.

Mbas pyetjeve dhe diskutimesh të lira në këtë konferencë solli përvojë edhe znj. Elizabeta Gjeorgjevska, eksperte për zhvillimin rural në Maqedoni pranë organizatës "Për zhvillim të Qendrueshëm", pasi Maqedonia është më afër realitetit shqiptar. Nga diskutimet e pjesëmarrësve u evidentuan nevoja e njohjes në

detaje e resurseve dhe mundësi në të dy anët e kufirit, problemet që mund të lindin, rritja e kapaciteteve, partneriteti i institucioneve shtetërore me shoqërinë civile, hartimi i strategjive për të ardhmen, mungesa e kapaciteteve në komunitet, mungesa e bashkëpunimit qendër-rreth, kushtëzimi për hyrjen në projektet e BE, nevoja e ngritjes së një qendre koordinimi në qarkun Korçë, roli i bashkive dhe komunave, si dhe roli i grave.

Drejtesit nënvizuan se qarku i Korçës është para në shumë aspekte.

Del nevoja e trajnimit të përfaqësuesve të ndryshëm për hartimin e projekteve. Korça do të zhvillojë një aktivitet të tillë në muajin nëntor 2009 me palën greke në hotel "Grand" në Korçë. Në mbyllje të konferencës u kërkua që të gjitha institucionet, Shoqëria Civile në qendër e në bazë të gjallërojnë më shumë punën në këto aspekte të trajtuara në këtë konferencë rajonale.

Korçë

-Me rastin e 110-vjetorit të lindjes së lirikut të madh shqiptar, poetit, Lasgush Poradeci.

Në këtë përvjetor poeti kujtohet nga dashamirës të poezisë dhe të artit, por harrohet nga pushtetarët. Në sallë nuk kish asnjë përfaqësues apo titullar nga institucionet dhe pse të lajmëruar për aktivitetin. Zgjedhje e tyre. Nëse vjen qoftë një ministër i thjeshtë apo një deputet i zonës nga mbrapa ka jo vetëm titullarët, por dhe administratën. Po kur vijnë figura që e kanë mbyllur karrierën dhe kanë lënë veprat gjallë, pushtetarët përtohen. Përtime të tilla bien në sy të pjesëmarrësve, por para materialeve për figurën që janë mbledhur as u intereson se marrin pjesë apo jo pushtetarët lokalë. Pushtetarët janë të përkohshëm, artistët dhe poetët të përmasave të Lasgush Poradecit mbeten liqer me puhiza dhe erë. Kush nuk piu prej tyre e s'u deh, qoftë dhe pak... Artistë të kalibrit të Lasgushit ngjiten gjithmonë lart për të zënë një vend përëndie dhe trokasin për të hyrë në mijëvjeçarë.

Mbrëmja poetike

Për tri orë në sallën e bibliotekës "Thimi Mitko" në qytetin e Korçës miqtë e mbetur të poetit, miqtë e rinj që e ruajnë madhësitë e tij, kuvenduan me lirikën si t'i dëgjonin ato vetë nga goja e të madhit Lasgush. Për ta bërë sa më të këndëshme këtë mbrëmje në sallonin e hyrjes u çel ekspozita me



Mbrëmje poetike për Lasgushin

veprat e Lasgush Poradecit nga Mehmet Gëzhilli.

Për të hyrë në botën lagushiane, në fillim u recitua një poezi e Skënder Rusit kushtuar 110-vjetorit të lindjes e titulluar "At Lasgushit në 110-vjetorin e lindjes." "Nuk e dimë ç'i mungonte poetit/ Toka që e lindi apo qielli që e priste!/? Ndoshta për ta kuptuar këtë/ pranoi që të ikte!" Nga aktorët e teatrit u sollën vargje në sallë, të cilat u recituan me një ëmbëlsi e qetësi vale

si vetë lirikën. Kritiku i njohur korçar Muharem Xhaxho kaloi në "skaner" krijimet e Lasgush Poradecit. "U harrua për një kohë të gjatë dhe në kohën kur ishte gjallë njerëzit e dinin se ai kishte vdekur. U harrua poezia e tij, ndoshta qëllimisht nga pushteti i kohës. Lasgushi mbetet Lasgush në çdo kohë" -citoi mes të tjerash kritiku. Muzikologu Pandi Bello foli për miqtë e Lasgushit në Europë dhe ndikimi i tyre në formimin e

tij. Një poezi të bërë enkas për poetin liqenor recitoi poeti Ali Bregu. Në fillim të recitimit Ali Bregu tha se zor gjen sot poet që nuk i ka shkruar vargje babait të lirikës shqiptare.

Në këtë mbrëmje poetike merre pjesë edhe vajza e Lasgushit, Marie Poradeci, e cila solli episode nga jeta e babait të saj. "Më kujtohet kur babai vinte e merre libra në bibliotekë, për t'i përkthyer. I qëllonte që të merre dhe një libër tjetër, pa e dorëzuar të parin. Punonjësja i thosh se pa kthyer të parin nuk merr të dytin dhe i lexonte rregullohen e brendshme të bibliotekës, ku thuhej se personi që nuk kthen në kohë librin ka masë dënimi. Po nuk thotë për mua, ia kthente babai. Punonjësja ia lexonte e rilexonte disa herë. Babai në fund i thosh që unë nuk jam person, por personalitet." Pastaj u ndoq një dokumentar për Lasgushin. Por ajo që na ra në sy në mbrëmjen poetike kushtuar Lasgush Poradecit ishte mungesa e pushtetarëve. Nuk kish asnjë përfaqësues nga bashkia, as nga prefektura dhe Këshilli i Qarkut.

Në vitin 2002 nga Këshilli i Qarkut i është dhënë titulli "Nderi i Qarkut." Kryetari i qarkut në atë vit ishte Femi Xhemo. Figura të tilla si Lasgushi, Asdreni, Mihal Grameno e të tjera figura brilante të qarkut nuk duhet të lihen në harresë nga pushtetarët.

Pëllumb Çuni

Poradeci në 110-vjetorin e lindjes

Qendra Kulturore "Lasgush Poradeci" dhe Bashkia e qytetit, në mbrëmjen e datës 24 tetor 2009, organizoi një aktivitet kulturor-artistik kushtuar 110-vjetorit të lindjes së poetit Lasgush Poradeci.

Poeti gjithë jetën dhe veprën e pavdekshme letrare ia kushtoi dhe e motivoi me qytetin e tij të lindjes me të gjitha të mirat e begatitë, që ia ka falur Zoti: natyrën, njerëzit, kodrat, malet, por mbi të gjitha Liqerin pa kufir...

Besojmë se organizatorët kjo i kishte motivuar për ta zhvilluar aktivitetin në diskon "Mateo" mbi ujrën e liqenit. Ishin të pranishëm

zoti Artan Shkëmbi dhe punonjës të tjerë nga stafi i Bashkisë, këshilltarë, studiues e punonjës të artit e të kulturës të qytetit, autorë librash kushtuar Lasgushit, qytetarë të thjeshtë, miq etj. Për të gjallëruar aktivitetin ndodhej grupi "Mall për këngën Poradeci", që prej vitesh drejtohet nga kompozitori Jovan Shuke.

Konferencierja Marjana Shkurti pas fjalës falënderuese të hapjes i drejtoi pjesëmarrësit të shohin dokumentarin kushtuar punës së Bashkisë, për realizimin e monumentit të pavdeksisë kushtuar poetit, punuar nga "Skulptori i

Popullit" M. Dhrami. Aktiviteti vazhdoi me biseda të lira, konsiderata duke filluar me zotin T.Mato, i cili solli, ndër të tjera, jehonën e veprës dhe të jetës së Poradecit jashtë kufijve. Zoti A. Kostandini solli kujtime dhe këndvështrime të reja për poetin në fushën e artit të pikturës, duke sjellë dhe ilustrime nga jeta e Lasgushit.

Por nuk mungoi edhe prezantimi, disi befasues, nga pedagogu i Universitetit të Korçës "F. Noli", zoti Ilir Shyta. Një punim shkencor me vlera të spikatura, një sintezë e një bibliografie të arsyetuar, botim i Entit Botues

"D.I.J.A-Poradeci", me të cilën Shyta fitoi titullin "Master në letërsi".

Ndër të tjera, surprizë ishte poezia që botohet për herë të parë me titull: "Dashuri Dardhare".

Si duhet parë dhe vlerësuar Lasgushi, solli mendime zoti N.Naço, V.Samsuri, A. Gusho, e të tjerë.

Interpretimi skenik i disa poezive lasgushiane, tavolinat e shtruara, urimet, mikroekspozita me fotot e poetit, botime të Lasgushit dhe të të tjerëve për të shprehur më së miri respektin dhe vlerësimin, që i bënë qyteti i lindjes Poradeci Poradecit, birit të tij, poetit të madh Llazar Gusho (Lasgush).

Dhe ky mbetet një homazh përjetësie!

Idealistët i bëjnë ca gjëra që s'i bën njeri!

Menduar se i ftuam të gjithë në festën e Nositit, por u gabuam. Printuam 1000 ftesa dhe i shpërndamë ngado në Pogradec, pastaj dërguam dhjetëra e-maile, pastaj kërkuam “ndihmë” në Facebook (a s’është në modë FB?!), pastaj dërguam njoftime e spote në TV lokale, pastaj...

Morëm qindra urime dhe po aq ankesa. Kushdo që nuk e kishte marrë një ftesë ndjehej i zhgënjyer. Në vend që të mërzhiteshim, ne botuesit, unë dhe Iliri u gëzuam.

Nositi s’na përkiste më. Ashtu siç e kishim paradherë qysh në krijimin e tij. Nositi është i Lasgushit, e Lasgushi është i Poradecit, e rrjedhimisht Nositi është i poradecarëve, sipas një rregulli të thjeshtë matematik. Sepse ata e

krijuan, i dhanë jetë, mbushën mijëra faqe në këta vjet, prej tyre mbijetoi. Por është dhe pak më shumë. Është i të gjithë atyre që i thonë “confirm” ftesës për t’u bërë Miqtë e Nositit, në Facebook.

Në 110 vjetorin lindjes së Lasgushit, kuptova dhe diçka më shumë. Lasgushi është më shumë se një gjeni lokal...

Është në krenarinë e të gjithë atyre shqiptarëve që e kanë lexuar, e kanë vlerësuar dhe duan ta përkujtojnë në përvjetorët e lindjes, por edhe të vdekjes, për ta bërë më të dukshëm tani që s’ka kush t’ja mbulojë me heshtje veprën. Kështu është dhe Nositi, që lindi në vendlindjen e Lasgushit, për të kapërcyer kufijtë e një qyteti të vogël,



falë teknologjisë dhe fatit që kudo në botë ka idealistë pogradecarë, korçarë, shqiptarë nga e gjithë Shqipëria, nga Maqedonia, Kosova.

Tani shkrimet vijnë në redaksi nga e gjithë treva shqiptare, se tani, Nositi nuk shkon si dikur klandestin në Strugë, tek Xhemiu e miqtë e tij, as fshehur në bagazhet autobuzëve për Kosovë. Tani kufijtë kalohen pa vizë e pasaportë, on-line!

Dikur ndoshta... Kur ca “refugjatë lufte”, siç i quanin nëpër lajme kosovarët, mbushnin “Faqe të hapura” tek Nositi, me dhimbjen e tyre për Tokën Shqiptare. Dhe festuan bashkë me ne 5-vjetorin e gazetës, tamam në ditën e shënuar 14 qershor 1999.

Botuesi i Kosovës Abdullah Zeneli habitet e më shkruan në chat:

“Po çfarë më thua, Viti? Është 15-vjetori i Nositit?! Kështu?! Kur kaluan 10 vjet nga ai përvjetor që festuam bashkë në Pogradec?! Mes trishtimit të luftës, e plagëve të shpirtit ende të pambyllura?!”

-Nuk e di, i përgjigjem. Edhe vetë habitem, për të gjithë, botuesit, stafin e gazetës, bashkëpunëtorët, të rinjtë e shkollave e mësuesit e tyre, lexuesit e dashamirësit që mbushën rubrikat e Nositit gjatë këtyre viteve. Si mundëm të mbijetojmë vallë?

Mesazhi nuk vonon të duket në ekran: Idealistët i bëjnë ca gjëra që s’i bën njeri!

Afroviti Gusho

Nga data 4-6 nëntor u mbajt në Tiranë, Forumi i tretë për median në Evropën Juglindore: “Media, Marketingu, Biznesi dhe Media e re”, organizuar nga grupi mediatik ÉAZ, fondacioni Konrad-Adenauer, si dhe Organizata për Median e Evropës Juglindore (SEEMO) dhe bashkëpunëtorët e tyre në Shqipëri. Në prani të përfaqësuesve dhe drejtuesve të lartë të këtyre organizmave: Z. Oliver Vujović, Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës për Median e Evropës Juglindore në Vjenë, Z. Srgjan Kerim, Këshilltar i Posaçëm për çështjet politike të Grupit mediatik ÉAZ në Maqedoni Maqedoni, Z. Dirk Forger, Drejtor i Programit të Medias për Evropën Juglindore (KAS) në Bullgari, si dhe të Z. Frrok Çupi, Kryetar i SEEMO në Shqipëri, si dhe të tjerë personaliteteve të spikatura në fushën e medias, Presidenti i Republikës mbajti një fjalë përsëritëse. Presidenti Topi vuri në dukje rëndësinë thelbësore të misionit që mediat mbartin. “Misioni është fisnik, sepse përgjegjësia e saj qytetare, besueshmëria që gëzon nga qytetarët dhe detyrimi për t’u shërbyer atyre nuk është akt ligjor, por mbi të gjitha është kod moral dhe i shenjtë, i lidhur nëpërmjet lirisë, pavësinë e të vërtetës që vetë media e ka fituar në betejat historike me pushtetin politik. Beteja me politikën nuk duhet ta lodhë, as ta lëgështojë e as ta thyjë atë.

Çdo puthjedore e politikës për të



Presidenti Topi vlerëson rolin e medias

braktisur misionin është jo vetëm robëri dhe dështim moral ndaj qytetarëve, por edhe kthim pa shpresë mbrapa me pasojë të rrezikshme për demokracinë dhe vendin”, - u shpreh Presidenti Topi.

Presidenti i Republikës, Bamir Topi, duke iu referuar sulmit ndaj gazetarit Mero Baze, tha se ky sulm duhet të ngrejë në alarm institucionet e shtetit.

“Më duhet të dal nga materiali i shkruar pikërisht për një moment, i cili na bëri të gjithëve të ndjehemi keq, dhuna ndaj një gazetari. Nuk është herë e parë, uroj të jetë dhe rasti i fundit. Që të jemi realistë, shoqëria gjithmonë do të

ketë dhe episode të tilla të pakëndshme. Çështja nuk është thjesht te reagimi nëpërmjet deklaratave. Jemi mësuar të dëgjojmë gjithnjë deklarata dhe deklarata postfactum dhe për fat të keq ndonjëherë edhe postmortum. Gjërat kanë nevojë për profilaksi, gjërat kanë nevojë për bashkëpunim, gjërat kanë nevojë për sinqeritet, gazetarët kanë nevojë të kenë një terren të lirë, por nga ana e tyre dhe gazetarët kanë nevojë që të kenë integritet. Integriteti nuk injektohet, integriteti duhet të demonstron. Të gjithë së bashku kemi shansin që jetojmë në ditë demokracie.

Ju e dini që edhe në tregun mediatik ka media që në mënyrë të qartë janë të profilizuara në një drejtim, janë kompakte, saqë është e vështirë ndonjëherë të gesh, nëse janë gazetarë apo janë parti politike, pra një lloj joint-venture duke i shërbyer një linje dhe nuk i shërben publikut. Publiku ka nevojë të orientohet dhe është detyrë e medias dhe është domosdoshmëri që publiku të jetë i orientuar në mënyrë harmonike. Aq më keq kur denaturohet misioni i medias në një joint-venture të natyrës ekonomike. Pra, të gjithë së bashku duhet të injektojmë demokraci në këtë funksionim të domosdoshëm të medias, e cila domosdoshmërisht duhet të ketë lidhje me politikën, me institucionet, me biznesin, por të jetë në një terren të ndershëm integriteti.

Ngjarja, do të thosha e papranueshme, e dhunimit të gazetarit duhet patjetër të ngrejë në alarm institucionet e shtetit dhe kjo nuk mund të vijë në formën e orientimit nga Presidenti, por në një shtet demokratik të gjitha institucionet kanë përgjegjësi dhe detyrime specifike për të vendosur, jo vetëm standardet e shtetit ligjor, por për të garantuar klimën. Ka politikanë që nuk i zë gjumi, derisa të nxjerrin titujt e gazetave. Kjo është pak dhe kjo nuk ka vetëm një aktor, ka disa aktorë dhe këtu ka një joint venture të politikës me median. Pra, të gjithë së bashku duhet të dimë ta vëmë median në funksion të shoqërisë”

Urime, mesazhe

Urime dhe përgëzime gazetës NOSITI, kësaj tribune të pasqyrimin të përditshmërisë së jetës në rreth dhe më gjerë, të sjelljes së mendimit të gjallë e të lirë qytetar, të botimit dhe propagandimit të kulturës dhe të veprimtarive artistike; për mbështetjen dhe propagandimin e krijimtarisë letrare dhe të mendimit kritik.

Falënderime të sinqerta stafit të saj të përkushtuar, të drejtuar me pasion nga zonja Afroviti dhe zoti Ilir që për pesëmbëdhjetë vjet me radhë kanë guxuar dhe kanë çarë shtegun e një gazetarie të pavarur, novatore dhe demokratike. Vazhdimësi dhe suksese të mëtejshme! Me respekt

Vangjush Ziko, Toronto

Miqte e mi Afroviti dhe Ilir! Ju falënderoj për ftesën për të marrë pjesë në mbrëmjen festive të 15-vjetorit të gazetës "Nositi". Më kujtohen ato ditë kur Ilir Buzali më tregoi së pari gazetën "Nositi". Dukej gazetë modeste, pa zhurmë por që kishte një mision paksa larg sherreve të mëdha politike, të prekte problemet e jetës sociale, fatin e njeriut, dramën e tij, ëndrrat e tij... Me sa duket Nositi ishte fillesa e një synimi më të gjerë pretendues intelektual. Gazeta - shtëpia botuese -shtypshkronja një trinom që japin të plotë grehinën e një qendre ku gjenerohet kultura dhe arti. Ju uroj për këto suksese miqtë e mi dhe kam zili të gjithë ata që do marrin pjesë në veprimtari.

Suksese!

Kostaq Duka, Chicago

Përsëritje Viti & Ilir dhe shumë urime të përzemërta në këtë 15 vjetor të NOSITIT ku nuk mund të rrija pa shkruar dy fjalë për ju që me punën dhe me përkushtimin tuaj arrini të shpërndani dije dhe informacione gjithandej. Ju nxirrni në pah dhe promovoni njëkohësisht jo vetëm vlerat e bizneseve që bashkëpunojnë me ju, por dhe vlerat e qytetit në përgjithësi. Është fat për Pogradecin që ka një shtypshkronjë ku në çdo kohë mund të japësh dhe të marrësh informacion, dhe kjo falë inisiativës dhe guximit tuaj.

Edhe njëherë suksese në punën tuaj sa të vështirë, të bukur por dhe fisnike.

BAR-RESTORANT-HOTEL- PERLA
Singerisht

Moza & Petriti

Të dashur botues Afroviti dhe Ilir, Të dashur pjesëtarë të tjerë të ekipit të "Nositi"-t, Është një ide nga më fatlumet që sot kremtojmë ditëlindjen e Nositit, këtij djaloshi pesëmbëdhjetëpranverësh, mendjekthjellë si

Liqeri, shpirtthellë e të begatë si mineralet e çmuara që mban në gji, tej pamës si syri i Shqiponjës së arratisur në Mal të Thatë. Një dhjetëvjetësh e gjysmë janë një kapitull i ndritshëm i afirmimit gjithëpërfshirës të një kolektivi gazetarësh, afirmim që do të donim ta shihnim të mishëruar edhe në të përditshme, të përjavshme apo të përmuajshme të tjera shqiptare. Jeta e "Nositi"-t, me përpjekjet, mundin, vështirësitë e peripecitë e parreshtura, njësohet me përpjekjet e frytshme mbarëkombëtare për progres shoqëror e kulturë demokratike të mirëfilltë. Shkrimet e të gjitha gjinive e madhësive, që i lexojmë me ëndje e nderim në faqet e "Nositi"-t, kanë dhuntinë e mbartjes së rolit të një udhërrëfyesi për opinionin publik poradecar e më gjerë. Me vrullin e një spontaniteti të ngrohtë, "Nositi" është shkrirë në mënyrë të natyrshme e të përkryer me mjedisin të cilit i drejtohet; me penën e tij flet çdo pjesëtar i bashkësisë, vetë populli. Krahas kësaj garancie morale, "Nositi" zotëron një orientim intelektual të epërm, duke qëndruar afër shqetësimeve të përditshme qytetare, si një këshilltar i mirë, i besueshëm, origjinal.

Jetë të gjatë dhe rini të përzetshme, "Nositi" i dashur!

Me respekt, Kopi Kyçyku

URIME edhe 100 vite të tjerë "NOSITIT" në 15-vjetorin e ditëlindjes. Mbarësi dhe suksese te mëtejshme.

Me gjithë dëshirën e madhe për të qenë i pranishëm në festën e "Nositit", një problem shëndetsor më kushtëzoi për të mos udhëtuar drejt PORADECIT të mrekullueshëm, për të cilin singerisht më ka marrë malli. Edhe një herë urime për ditëlindjen e "NOSITIT". Të fala gjithë stafit.

Me shumë respekt **Bedri Alimehmeti.**

Përsëritje nga Tirana.

Dear Iliri dhe Afoviti Praise God for your 15 years of blessing with the New Paper Nositi. He has give you all your abilities and has blessed very much and given you a real passion in your work.

Sorry we can't be there as you know we are in Spain but we are glad for you and trust all will go will.

May the Lord bless you as a couple to know more and more of His love.

Your friend Felipe

Përsëritje Viti dhe shumë faleminderit për ftesën.

Unë jam në Itali për punë e nuk di kur kthehem, ndaj ju uroj si ty dhe Ilirit të keni

shëndet e dëshirë për ta botuar dhe 100 vjet të tjera Nositin.

Ju përqafoj,

Vini

Përsëritje Viti,

Uroj të jesh mirë.

E mora ftesën me anë të e-mail dhe u ndjeva shumë e kënaqur që unë bëj pjesë në miqtë e tu. Po të uroj në avancë për 15-vjetorin e gazetës, pasi më bëhet shumë qejfi që keni arritur deri këtu.

Besoj që bëhet fjalë për Pogradecin, per evenimentin, ku ndodhet dhe redaksia e juaj apo jo? Nëse është kështu do të përpiqem të krijoj ndonjë mundësi për të ardhur.

Gjithësesi, të përsëritjes sërisht dhe të uroj suksese të mëtejshme!

Me shumë respekt,

Valbona

Dear Afroviti

Thanks very much for the kind invitation and it would have been a great pleasure to come to Pogradec on that Saturday 17.10.2009. However I will be in Prishtina (first time after almost 10 years) and thus be prevented to attend.

Nevertheless I wish you a lot of success and a wonderful day!

With kind regards.

Daniel

Ju dërgoj urimet e mia më të mira me rastin e përvjetorit të gazetës Nositi.

Arjan Kallço

E dashur Viti!

E lexova ftesën tënde dhe shpresoj të jem aty, megjithëse nuk kam qënë ndonjë bashkëpunëtorë kushedi se çfarë. Me sa duket më mban me hatër.

Të përqafoj, shihemi së shpejti.

Silva

Shpresoj që nesër t'ia kaloni mirë me rastin e 15-vjetorit të gazetës tuaj. Ne do kishim ardhur me shumë kënaqësi, por këtë fundjave, pra nesër dt.17 dhe pasnesër kemi workshopin e Trajnimit për Trajnerë në Linzë. Do shihemi besoj në fund të muajit në workshopin e radhës dhe do jemi miqtë tuaj në Pogradec herën tjetër kur të vijmë andej, besoj shpejt.

Gjithë të mirat,

Vildani

Viti dhe Ilir,

Në pamundësi për të ardhur ju uroj përzemërsisht 15 vjetorin e "Nositit". Paçi përvjetorë të tillë gjithmonë dhe suksese.

Përzemërsisht

Piro Shkaba

Ndue Lazri**FIONGOJA***-Vajzës sime, Keda-*

Shtatë vjeçe
në zonën neutrale midis dy shtetesh.
Nën dritën e hënës
fiongoja jote e bardhë
mund të tërhiqte
shënjestrën e snajperëve kufitarë.

Ta hoqën
dhe e flakën për tokë
si një flutur të vrarë.

Nuk u ktheve ta merrje,
veç dy pika lot
qanë fëmijërinë
që mbeti në vijën kufitare.

Përpara teje
rruga e dhimbshme e mërgimit
me gojën lubi
që s'kursen asnjë moshë.

E rritur, tashmë,
gëzime na sjell çdo ditë,
por as velloja e bardhë
mbi kokën tënde
s' do ma heqë dhimbjen
e asaj fiongoje të vogël...

Kozeta Zavalani**Gllënjka e Karaibeve**

E piva edhe gllënjken e fundit
nga gjinjtë e Karaibeve
sikur t'i jepja puthjen e fundit.

Gjethet shumëngjyrëshe,
Ndryshuan ngjyrë
Për të më mbuluar
Në fshehtësinë e tyre
Habitshëm folën zogjtë kureshtarë
-Mos ka shkalluar kjo valle?!
-Por unë s'bëj asnjë prapësi
Veç me natyrën bëj dashuri
luaj e dashurohem
herë me erën, herë me retë,
herë me rrezet e diellit të nxehtë
E në këtë lojë aspak të fshehtë
palmat kureshtare më ndjekin me sy.
U them:
-Mos më keni zili
Unë do të iki përsëri.
Ju i keni të gjitha mrekullitë
Më lini t'i shijoj, të paktën dhe një ditë!
Eh, Karaibet,
një ëndër e rrallë.
Pranvera më zgjoi në një përallë....

Luleshpresat

Shpesh
në vetminë e pangjyrshme të shpirtit
përleshën,
ëndrra të masakruara.

Këngë të varrosura
shpërthejnë si vullkane me llavë.
Luleshpresat,
në shpirtin e trazuar bulëzojnë,
me tjetër aromë,
sikur kërkojnë të më dehin
Mes tyre
ndjehem e lirë.
Ndaj si bletët luleve
të fluturoj dua
endur në flladin pranveror.
Luleshpresat mbjell në kufijtë e ditës
Në pragpranvere për të lulëzuar
Gjatë katër stinëve të shpirtit
Dhe ëndërrën e fundit tua jap
Duke ia marrë jetës.
Lart në qiell të furtunës vozis
Ardhur me një grusht uji nga e djeshmja
luleshpresat të ujis.

Silke Blumbach**Gjenerali Jin***këto kodra me terraca
e presin Gjeneralin Jin*

Kjo cigare aq e shkurtër
nuk është hekur mjaft i rëndë
për t'i lëmuar nervat.

U betova t'i luftoj demonët. Premtova
që korren ta siguroj. Për 49 ditë u përgatita
për Gjeneralin Jin.

Trupi im u copëtua dhe u tha.
Nga tymi i lëvozhgës sime
doli një trup i pastër qiellor –

trupi i Luftëtarit të Përsosur,
i cili shkëlqen vetvetiu
me fuqi zanafillore...

*midis kodrave me terraca
pret një flamur me shirita*

Asnjë gabim s'duhet ta bëj
në fjalët. Asnjë rrëshqitje gjuhe. Aspak
të pengohem. Shiritat duhet të lëvizin
nga Gjenerali Jin. Nëse ai e plotëson
kontratën. Asnjë shpërqëndrim mendor.
Asnjë pasinqueritet. Trupi, goja, zemra
të pastruar. Njëqind përqind ciltërsi. Pa
kompromis. Asnjë pasiguri. Asnjë
pasiguri... Po duhet të lëvizin
këto shirita! Duhet! Asnjë rrëshqitje.
Asnjë gabim. Asnjë njollë. Asnjë
të metë. Asnjë gabim. Asgjë. Asnjë
pasiguri... Gjenerali Jin! Ku je! Preki
shiritat! Mos më tradhëto!... por

perëndia
është i lirë dhe nuk
burgoset në
përsosmëri...

*këto kodra me terraca
do të lagen, por jo nga uji*

Fituesit e konkursit me rastin e 15-vjetorit të gazetës "Nositi"

Çmimet në poezi

1. **Kozeta Zavalani**, çmimi i parë për cikël me poezi
2. **Ndue Lazri**, çmim special për poezinë "Fjongo"
3. **Silke Blumbach**, çmim special për poezinë "Gjenerali Jin"

Botimet më të mira

1. Libri më i mirë poetik: "Mos e ndiqni hijen", nga **Edmond Shallvari**
2. Libri më i mirë në prozë: "Borëbardha flokëthinjur", nga **Vangjush Ziko**
3. Libri më i mirë me studime: "Ringjallet Rilindja e Lasgushit. Po unë?" nga **Petro Prifti**.

Në vlerësimin e botimeve më të mira të Sh.B. "D.I.J.A Poradeci" juria ka mbajtur parasysh të gjithë komponentët e një libri: nivelin artistik të tekstit, realizimin grafik dhe kopertinën, cilësinë e shtypit.

Juria: **Leonora Kere, Ilir Shyta, Ana Kove, Ilir Buzali, Afroviti Gusho.**

15 VJET NOSITI

Projekti i Komisionit European në Korçë dhe Pogradec

Buxhetim me pjesëmarrjen e qytetarëve

Një nga fushat e rëndësishme programore të Komisionit European, në kuadrin e zbutjes së varfërisë dhe në kuadrin e harmonizimit të lëvizjeve për globalizim dhe zhvillimin ekonomik të qyteteve, është dhe mbështetja e shoqërisë civile në iniciativat anti-korrupsion në Shqipëri.

Në këtë kuadër, me iniciativën e Bashkisë Korçë dhe Pogradec, Instituti i Kërkimeve Urbane, mbështetur nga Komisioni European, ka ndërmarrë një proces shumë të rëndësishëm të përfshirjes së qytetarëve në procesin e hartimit, miratimit dhe monitorimit të buxhetit të vitit 2010. Ka rreth 3 muaj që ky proces ka filluar. Procesi quhet buxhet me pjesëmarrje dhe logot e përgatitura nga Bashkia Korçë e Pogradec janë përkatësisht: "Fjalën e ke TI" dhe "Sot vendos edhe TI".

Si po realizohet procesi

Puna përgatitore: Bashkitë e kanë filluar punën me sensibilizimin e opinionit publik nëpërmjet medias, fletëpalosjeve, posterave në qytet dhe zona të ndryshme. Në çdo Bashki janë ngritur grupet e punës teknike, janë përgatitur materialet prezantuese për çdo zonë dhe janë zgjedhur koordinatoret, që do ta shoqërojnë të gjithë procesin deri në fund. Qytetet u ndanë në zona të veçanta, ku u përfshinë disa lagje, sipas veçorive të tyre dhe takimet u organizuan në ambiente pranë çdo zone.

Si është proceduar në çdo takim: Instituti i Kërkimeve Urbane ka prezantuar në mënyrën më të thjeshtë se si mendohet të organizohet i gjithë procesi dhe konkretisht:

- Çdo qytetar është i lirë të propozojë çdo problem dhe shqetësim që ka në lagjen e tij lidhur me infrastrukturën, shërbimet publike dhe qeverisjen më të mirë.

- Të gjitha shqetësimet do të shënohen në një tabelë, e cila do të shërbejë për përzgjedhjen e disa investimeve që janë më prioritare për ta.

- Çdo lagje do të përfaqësohet në një komision të buxhetimit me pjesëmarrje të ngritur pranë Bashkisë me dy qytetarë të zgjedhur nga vetë ata, aktivë dhe që kanë më shumë kohë për të qenë pjesë e trainimeve të mëtejshme dhe e çarjes së procesit deri në fund.

- Do të ngrihet pranë Bashkisë një



komision i përbërë nga të gjithë të zgjedhurit e qytetarëve dhe specialistë të Bashkisë. I lirë, pa të drejtë vote mund të marrë pjesë çdo qytetar dhe këshilltar.

Konkluzione të takimeve: Tashmë kanë përfunduar takimet me qytetarët në gjashtë zonat në Korçë e tre zonat në Pogradec. Moderimi i tyre u realizua nga Instituti i Kërkimeve Urbane, për të rritur më shumë besueshmërinë e qytetarëve në këtë proces tepër transparent. Në çdo takim kanë marrë pjesë mbi 30-40 qytetarë nga çdo zonë. Kryetarët e Bashkive dhe drejtuesit më kryesorë të tyre, kanë prezantuar arritjet në fushën e përmirësimit të infrastrukturës e shërbimeve në çdo zonë për vitet 2008-2009 si dhe projektet më të rëndësishme që priten në vitet e ardhshme. Çdo takim është shoqëruar me pjesëmarrjen edhe të këshilltarëve të interesuar për këtë proces transparent dhe të OJF të ndryshme. Çdo qytetar ka paraqitur shqetësimet e veta në lagje, por edhe për ato me interes të përbashkët publik. Nëpërmjet një votimi të hapur, çdo qytetar ka votuar për tre propozime për investime që janë më të domosdoshme të realizohen në lagjen e tyre.

Roli i shoqërisë civile në këtë proces: OJF dhe grupe vullnetarësh kanë ndihmuar për një pjesëmarrje sa më të lartë të qytetarëve në këto takime, nëpërmjet bisedave të veçanta derë më derë si dhe nëpërmjet telefonatave në familje. Në Pogradec një grup të rinjsh

nëpërmjet shoqatës "Unë gruaja" kanë shfrytëzuar takimet publike, për të shpërndarë tek çdo qytetar planin e investimeve kapitale të hartuar nga Bashkia për periudhën 2010-2014, nëpërmjet një komisioni qytetar, i cili mund t'i orientojë shumë mirë ata në perspektivën e zhvillimit ekonomik të qytetit. Çfarë kanë paraqitur në përgjithësi qytetarët në takimet publike: Korça tashmë ka përfunduar përpunimin e kërkesave të qytetarëve duke i kategorizuar ato në tre fusha: kërkesa për investime, kërkesa për përmirësim të shërbimeve të përditshme dhe kërkesa për përmirësim të transparencës së buxhetit, taksave dhe për një qeverisje më të mirë. Janë rreth 67 propozime qytetare për investime në qytet dhe 53 në fushën e shërbimeve publike. Me votim të hapur për efekt të mundësive të pakta financiare, janë përzgjedhur në çdo zonë nga tre investime me prioritet. Komisioni qytetar i buxhetimit ka një listë prej 18 investimesh, të cilat do të jenë objekt për përzgjedhjen e tyre për në buxhetin 2010. Bashkia Korçë me përfaqësuesit e qytetarëve bëri një verifikim në vend, në çdo lagje të propozimeve prioritare për qytetarët, mbasi lista prej 18 investimeve të propozuara nuk mund të mbështetet me burimet e fondeve të vitit 2010. Procesi po vazhdon.

Bashkia Pogradec është duke bërë përpunim dhe organizimin e

propozimeve qytetare sipas fushave (investime, shërbime, qeverisje). Megjithatë procesi do të përqëndrohet më shumë tek investimet, do të hartohet nga Bashkia dhe një plan veprimesh për zgjidhjen edhe të shqetësimeve qytetare për shërbime jo të mira publike e transparencë në procesin e mbledhjes së taksave, të buxhetit, lejava të ndërtimit etj.

Si do të vazhdohet më tej

Përfaqësuesit qytetarë të çdo lagjeje, të zgjedhur në çdo takim publik, do të kenë në dorë listën e plotë të kërkesave qytetare të të gjitha zonave. Ata duhet ta studiojnë me kujdes dhe të përgatiten për takimin në komisionin pranë Bashkisë, ku anëtarë me të drejtë vote do të jenë dhe specialistë nga Bashkia.

Komisioni do të trainohet nga Instituti i Kërkimeve Urbane për njohuri mbi buxhetin dhe mënyrat se si mund të bëhet përzgjedhja e prioriteteve.

Do të përshkruhet dhe diskutohet në komision çdo investim dhe përqëndrimi do të jetë për ato, të cilat janë përzgjedhur si më prioritare. Mbi bazën e disa kriterëve që do të propozohen nga Bashkia dhe do të votohen dhe nga qytetarët, do të zgjidhen ato investime që do të përfshihen në buxhetin 2010.

Përpara se të merret vendimi përfundimtar, grupi qytetar i shoqëruar nga stafi i Bashkisë do të shëtisë me një autobus dhe do të shikojë në vend problemet, do të marrë foto të ndryshme, për të qenë më të përgatitur në argumentimin e vendimit përfundimtar. Komisioni do të përgatisë draftin përfundimtar të propozimeve.

Në një takim të zgjeruar me qytetarë të të gjithë zonave, me ndihmën e Institutit të Kërkimeve urbane 1-2 anëtarë të komisionit qytetar do të prezantojnë përpara tyre konkluzionet e punës së bërë, duke marrë konfirmimin për draftin që do të paraqitet në këshillin e Bashkisë.

Komisioni qytetar do të shoqërojë vendimmarrjen deri në fund: do të marrë pjesë në takimet e komisionit ekonomik të këshillit dhe në mbledhjen e buxhetit për të votuar produktin e punës qytetare.

Kjo do të jetë faza e parë e këtij procesi. Përgatitje akoma më serioze do të bëhen për procesin e monitorimit të buxhetit, për atë të realizimit të investimeve të buxhetuara.

Personalitete të tjerë të shquar e kanë cilësuar si princ të poezisë shqiptare, që po të kishte shkruar në Francë do të ishte i përmasave të Bodlerit e Malarmesë. Megjithatë, kritizerët tanë e kanë bombarduar Lasgushin me një seri anatemash, plotësisht të gabuara.

Në poezinë “Kur nuk ndjehesh fare mirë”, që ka mbetur e pakuptuar apo qëllimisht e harruar, Lasgushi, trajtoi sesi e përse poeti, intelektuali i kompletuar, shkencëtari, profesori apo njerëzit që ndriçojnë mbi të tjerët, janë shumë të ndjeshëm ndaj qëndrimeve nënvlerësuese, mbase edhe përcmuese deri në tallje, për punën e tyre, nga njerëz, pa dyshim të paformuar, por edhe nga njerëz me poste drejtuese në komuna, në rrethe, me sa duket edhe më gjërë, pa harruar edhe kritizerët e veprave të artit. Për këta në Kur’an shkruhet:

“Edhe të dërguarit e tjerë para teje, (është fjala për Muhamedin, shënimi im), janë përqeshur, e ata që u tallën, pësuan për shkak se talleshin.”

Me sa duket të ndjerit e vetes mirë, po jo fare mirë e ka përjetuar edhe Lasgushi, të cilin Kuteli, Çabej, Luarasi, Kadareja e të tjerë, e kanë poet të përmasave europiane e botërore. Personalitete të tjerë të shquar e kanë cilësuar si princ të poezisë shqiptare, që po të kishte shkruar në Francë do të ishte i përmasave të Bodlerit e Malarmesë. Megjithatë, kritizerët tanë e kanë bombarduar Lasgushin me një seri anatemash, plotësisht të gabuara. Atë e kanë quajtur idealist, agnosticist, skepticist, panteist, pesimist, qe ka rënë në pozitë e misticizmit, eklektizmit, animizmit, formalizmit, artificializmit, manierizmit, teozofisë, etj, etj.

Sot, në kushtet e pluralizmit, këto karakteristika apo të kundërtat e tyre, nuk luajnë asnjë rol në përcaktimin e artistit në përgjithësi e poetit në veçanti, si poet gjeni, poet i madh, i mesëm apo i rëndomtë, etj. Mirëpo në kushtet e diktaturës, ato ishin jo vetëm të papranueshme, por edhe të dënueshme.

Shkrimtari dhe studiuesi i shquar Nasho Jorgaqi, ka shkruar se kritizerët e Lasgushit kanë dhënë gjykime në një kohë të vështirë, kur trysnia ideologjike nuk i lejonte të shpreheshin LIRISHT dhe SINQERISHT. Kjo kritikë mediokre ia nxu jetën Lasgushit, i cili nuk shkroi më shumë se 100 vargje në vit. Po të kishim një kritikë të vërtetë shkencore, Lasgushi të paktën do të kishte shkruar 1000 vargje në vit, pra dhjetë herë më

Pak dritë, për librin Ringjallet Rilindja e Lasgushit!



shumë, pra do të kishim 10 Lasgushë.

Kritizerët tanë kanë qënë skuadra e pushkatimit të 9 Lasgushëve, për të cilët nuk mund të thuash “punë e madhe”, sepse njerëzit e mëdhenj janë prikë e kombit, janë krenaria e tij.

Kritika ndaj Lasgushit po të ishte e LIRË dhe e SINQERTË, po të merrej edhe me gjysmën tjetër të vargjeve, për poezinë filozofike dhe erotike-filozofike të pakuptuar e të mënjanuar plotësisht, po të ishte shkencore, do arrinte që trysnia ideologjike e kohës ta përshëndeste atë dhe vetë Lasgushin. Në qoftë se ajo do të bënte fjalë për sistemin poetik të Lasgushit, ateizmin, materializmin, dialektikën, mbretërinë Qiellore Lasgushiane, për eksitim jo hyjnor, për gjuhën lasgushiane, për Lasgushin gjeni, për optimizmin lasgushian, për karakterin e theksuar social të poezisë lasgushiane, për karakterin kombëtar, për karakterin universal

të veprës së Lasgushit, për emancipimin e gruas shqiptare, për rolin e masave dhe të individit në shoqëri, për mundësinë e njohjes së botës, etj. Heshtja zyrtare do të ishte kthyer në një tingull zyrtar, në një zë zyrtar, në një vlerësim shumë të lartë zyrtar për talentin gjenial të Lasgushit. Kështu, tërë jetën e mbytën Lasgushin për idealizmin e tij, për misticizmin e tij! E megjithatë Lasgushi është një materialist tepër konsekuent. Mos u çuditni, kështu është. Kritizerët nuk kanë ditur të notojnë në kapitullin “Vallja e përjetësisë-zemra e përjetësisë”. Ai është tërësisht i pakuptuar prej tyre. Poezinë “Lënda dhe jeta”, me dy strofa, gjithsej tetë vargje, e kam analizuar në tetë faqe, për të argumentuar materializmin e Lasgushit.

Lënda apo materia e personifikuar e Lasgushit flet:

“Pata qënë, do të jem”

Pra si lëndë, si materie pata qënë, s’më ka krijuar kush.

Demiurg për lëndën s’ka. Filozofia u vu në binarë, pra s’ka frymë, s’ka ide etj, që mund të qëndrojnë krahas lëndës e pavarësisht prej saj. Në këtë mënyrë, materia është primare, pat qënë e do të jetë, s’ka kuptim të kërkohet kur u shfaq e kur do të zhduket. Ajo s’ka ditëlindje, s’ka ditëvdekje. Materia është pa kufi në kohë, është e përjetshme.

Në poemën “Vallja e yjeve” Lasgushi shkruan:

“Do të venë fluturim
Kudo janë e kudo s’janë
Nëpër qiell që s’ka mbarim,
As fillim, as fund, as anë.”

Në këto vargje, qielli në kuptimin e hapësirës, është i pafund. Kjo do të thotë që sipas Lasgushit, materia është e pakufizuar jo vetëm në kohë, por edhe në hapësirë.

Jo vetëm kaq, në libër kemi provuar që materializmi i Lasgushit është edhe dialektik.

Në këtë kuptim, po të flasim me gjuhën e filozofisë klasike gjermane, duhet të pohojmë se Lasgushi ka qënë më afër Ludvig Fojerbahut (1804-1872) dhe Georg Fridrik Hegelit (1770-1831) dhe më larg nga Johan Fihte (1762-1814), nga Frederik Shellingu (1775-1854) e sidomos nga Emanuel Kanti (1724-1804).

Sidoqoftë, vlerat madhore të veprës poetike të Lasgushit, sot në kushtet e demokracisë, nuk kanë asnjë lidhje me aftësinë e tij më të madhe apo më të vogël me njërin apo me tjetrin nga pesë përfaqësuesit më të shquar të filozofisë klasike gjermane që përmendëm më sipër, ndërsa, në kushtet e realizmit socialist, ato afërsi, kanë qënë edhe fatale.

Në lidhje më ateizmin e poetit, lexuesi që nuk është njohur me librin “Rilindja e Lasgushit”, duhet të ketë parasysh disa njohuri të dhëna në atë libër:

vijon nga faqja 11

Pak dritë, për librin Ringjallet Rilindja e Lasgushit!

Me mbretëri qiellore lasgushiane, do të kuptojmë diturinë e njerëzimit. Me mbretëri qiellore të fesë do të kuptojmë tërësinë e pikëpamjeve të të gjitha sistemeve fetare të marra së bashku. Zoti lasgushian, pastërtia e ndriçimi i tij, kërkon për banesë si vend përhapjeje, si vend vallëzimi të pikëpamjeve njerëzore, një mjedis të bukur, sublim, të madhërisëm siç është QIELLI.

Ndërgjegjia e njeriut konkret, kultura e tij, dituria e tij, që është nënbashkësi e Mbretërisë Qiellore lasgushiane ose të fesë, përbën SHPIRTIN lasgushian ose të fesë të atij njeriu, e bën atë një zot të vogël. Lasgushi kërkon të kemi mundësisht identitetin:

Poeti = Zotin lasgushian ose

Poeti = Zotin religjioz ose

Poeti = Zotin lasgushian + Zotin religjioz. Këto identitete janë ëndrra të bukura, fisnike dhe utopike.

Çfarë operacionesh ndodhin kur njeriu për një problem a vështirësi i adresohet Zotit, mbretërisë ideale qiellore? Njeriu ka bagazhin e diturisë së tij, SHPIRTIN e tij, është Zot i vogël. Këtë dituri e ka siguruar me shkollë, kurse, përvojën jetësore, me mjetet e informacionit, etj.

Kjo dituri është pjesë e mbretërisë qiellore, nënbashkësi e saj. Me këto njohuri njeriu psh nuk e zgjidh problemin konkret apo nuk e kapërcen dot vështirësinë. Kur themi që i drejtohet Zotit, kuptojmë që u drejtohet dijeve të tjera të mbretërisë qiellore që ai nuk i zotëron, me anë të të cilave e zgjidh problemin, kapërcen vështirësitë, argumenton mosdredhimin në besë, siguron forcën etj, pra ndihma e Zotit bëhet efektive. Si i siguron njeriu njohuritë shtesë për kapërcimin e vështirësive? Përsëri me studime, me konsultime me njerëz të tjerë, etj.

Zoti lasgushian është ndërgjegje, është botë ideale, prandaj është gabim i madh po të përfytyrohet si qenie lëndore, me mish, kocka e gjak.

Tani le të vazhdojmë me sistemin e plotë dhe të fortë poetik të Lasgushit, që është i vetmi në Shqipëri me një sistem të vetin të tillë. Me gjuhë popullore, mund të themi se me sistem poetik kuptojmë

tërësinë e vargjeve të poetit, me bashkësinë e përmbajtjes së tyre, të ndarë pastaj në nënbashkësitë e librave, nënbashkësitë e kapitujve, të cilët përbëhen nga nënbashkësitë e vargjeve të poezive të tyre. Tematika e gjerë e bën sistemin poetik të plotë, lidhja mjeshtërore e kapitujve e bën atë të fortë, ndërsa niveli i lartë artistik i poezive, e bëjnë atë të përkryer. Për poezinë “Zog’ i qiejve”, Kuteli shkruan se i ngjan një përmendoreje në miniaturë të veprës së Lasgushit, pra sistemit të tij poetik, ajo i përngjan edhe një harte gjeografike, e cila tregon gjithë pamjet fizike e gjithë konceptimin metafizik të Lasgushit, konceptimin mendor të Lasgushit.

Pra, kemi tre paralelizma figurative të fuqishme:

1-Midis bocetit të vogël e përmendores të madhe;

2-Midis 56 vargjeve të poezisë “Zog’ i qiejve” me rreth 6000 vargje të veprës së Lasgushit;

3-Midis fletës së vogël të një harte gjeografike, me malet

e fushat, lumenjtë e qytetit, pasuritë natyrore e njerëzit, me mijërat e kilometrave katrore të sipërfaqeve të vërteta që pasqyrohen në të.

Sistemi poetik i Lasgushit është tejet origjinal dhe i kompletuar.

Me këtë rast, po theksoj se vëllanë e madh të kryevargut homerik botëror, Kadareja e gjen në poezinë “Flaka” të Lasgushit:

Përmbys, o jetë

M’i fal stolitë,

Kujtim të qetë,

Plot zjarr, plot dritë.

Mirëpo, te profesor Xhaxhiu e te zonja Frida Idrizi gjejmë së paku edhe dy mendime të tjera të

ÇUDITSHME. Për veprën poetike të Lasgushit sipas tyre, kanë ndikuar negativisht:

Së pari, studimet në universitetet e huaja të Europës;

Së dyti, leksionet mbi rrymat e ndryshme filozofike.

Pra, Lasgushi do të ishte poet më i madh në qoftë se do të mbetej në formimin e tij në nivelin e arsimit

kesh dy ashtu, një ta çash e një ta mbash.

Në poezinë e Lasgushit shkruan Xhaxhiu, shumë shpesh i takojmë fjalët llaftari, fshehtësi, varfanjak, dhembshuri, pika lot, etj.

Në poezi nuk ka rëndësi sa herë e përdor një fjalë, rëndësi ka cilën fjalë përdor, si e përdor, sa është ngarkesa e saj ideoemocionale, etj.

Hajde xhevahir, hajde! A e di ç’ke thënë, z.Xhaxhi? nuk e di, se po ta dije nuk do ta kishe thënë. Xhevahiri juaj kërkon, ç’ të them dhe unë, xhevahiri urdhëron:

Kompozitor! Shtatë notat e tua t’i përdorësh në numër të barabartë! Pushkato Xhaxhi, pushkato! Fillo me Bethovenin!

Piktor! Shtatë ngjyrat e ylberit, por edhe përzjerjet e tyre, që sot e tutje t’i përdorësh në mënyrë të barabartë! Kë të zhdukim? Fillojmë me Rafaelin!

Po palloi i shkretë, që pendët e ndryshme nuk i ka me numër të njëjtë përse duhet asgjësuar?

Gjuhëtar! Në do ta nderosh gjuhën shqipe, reformoje atë, që shtatë zanoret e alfabetit të përdoren në mënyrë të barabartë!

Zot! E kuptove gabimin e madh që ke bërë? Ta tregon Xhaxhiu, mos u mërzhit. Dhjetë gishta këmbë, dhjetë gishta dore. Aferim. Përsosmëri!

Po dhjetë gishtat nuk i ke njëlloj. Papërsosmëri! Dhjetë gishta, dy sy, një kokë, gjithë ato dhëmbë, po fije floku sa? Po yje, planetë, satelitë, asteroidë, kometa nga sa ke?

Po kinezët, francezët e ganezët, pse s’i ke me numër të barabartë, pse?

Ngatërrohet Xhaxhiu si duket me numrin e llampave që duhet të jetë i barabartë me numrin e portollambave. Mirë, po ç’punë kanë fjalët e poezisë me llampat e portollambat e Xhaxhisë?

Lasgushi, sidomos nëpërmjet vargjeve të poezisë “shpirtit”, “Rri mbështetem në tryezë” dhe “Ylli”, terminologjinë e të cilave do ta respektojmë më poshtë, na ka lënë



të mesëm; do të ishte poet më i madh në qoftë se nuk do të studionte rrymat filozofike; mbase sipas këtij arsytimi naiv e fëminor, Lasgushi do ishte poet më i madh në qoftë se do të ishte gjysmë analfabet; do të ishte poet më i madh në qoftë se nuk do të studionte 25 vjet rresht nëpër vende të zhvilluara të botës, por, të ishte i izoluar në ndonjë “qeli”!!!

Zot, O Zot, je simbol i diturisë apo simbol i çmendurisë-idiotësisë?

Për njerëz të tillë edhe populli s’ka heshtur:

1.- Sa poshtë ka rënë katundi dhe

2.- Për njerëz të tillë duhet të



Pak dritë, për librin Ringjallet Rilindja e Lasgushit!

një lëksion me vlera të veçanta për artin poetik, për krijimtarinë artistike poetike.

Lasgushi i drejtohet shpirtit të tij, i cili, sikurse provuam më sipër nuk është religjioz: të adhuroj e të falem moj dituria ime, ndërgjegjja ime, që je vetë zot i vogël.

Në kushte të caktuara frymëzimi e përqëndrimi, dituria e mendimet e saj dritëdhënëse, depërtojnë në botën e ndjenjave, shkëmbejnë në të dhe i nxitin zemrës, botës së saj humane, me vargjet e shkruara në një çast, një harmoni të përjetëshme, një dashuri të madhe midis njerëzve.

Në kushtet e Yllit të ditës, dituria, kultura, ndërgjegjja, bota ideale, kanalizohen mendimet sipas temave të caktuara e shkruhet kënga në këto kushte frymëzimi, në këto kushte të përqëndrimit të vëmendjes së poetit në botën ideale të tij.

Trazimi i shpirtit të poetit, shpirtit joreligjioz të Lasgushit, është eksitim i ndërgjegjes, një eksitim që lidhet me poetin në gjëndje frymëzimi, në gjëndje përqëndrimi të vëmendjes në temën e caktuar, fryt tepër torturues i së cilës do të jetë poezia e shkruar. Cili është ngacmuesi? Bota e jashtme, e cila përpunohet shumë dhimbshëm në ndërgjegjen e poetit e rishfaqet në vargje prej tij. Ku ka këtu frymëzim hyjnor? Vërtet u frymëzua shpirti i Lasgushit, por ky shpirt nuk është religjioz, fetar, hyjnor. Rrjedhimisht nuk kemi të drejtë të flasim për frymëzim hyjnor të Lasgushit, por kjo nuk na ndalon të themi që te poeti kemi frymëzim qiellor, duke patur parasysh shpirtin e tij, që është nënbashkësi e Mbretërisë Qiellore lasgushiane, që ka si vendbanim QIELLIN.

Në përputhje me temën dhe titullin e vjershës, poeti, nga Mbretëria Qiellore lasgushiane thërret apo veçon idetë e njohura nga shpirti i tij e zë merret me përpunimin e tyre, dmth shpirti i poetit, u frymëzua për krijimin artistik.

E kupton poeti, se shpirti i tij i ka

të mjaftueshme idetë nga Mbretëria Qiellore lasgushiane, të cilat në formë FLAKE e HIJE kanë kulluar, janë futur në shpirtin e tij, janë përzgjedhur me mundim të patreguar e i ka ardhur radha, me ditë e muaj papushim, të shkruhet fjala, që nuk mund të shkruhej më parë, si kindë e parë, si varg, si strofë apo si poezi përbërëse e një kapitulli etj.

Studioja e poetit = atelieja e tij = ndërgjegjja e tij krijuese, mendja e zemra e tij, është një kaos i vërtetë temash e subjektsh, për të cilat duhet shkruar, të përpunohet pjesërisht apo të lena pas dore, të shkruara me fjalë, vizatime, grafikë ose jo, të plota apo të cinguar, pa fillim e pa mbarim, për të cilat nuk dihet me kë do fillohet e më kë do mbarohet. Në këtë kaos të tillë, gjendet rrugëzgjdhje nga drita e Përjetësisë, nga drita e diturisë së poetit, që ndriçon si në pasqyrë.

Ideja artistike apo poetike, si përmbajtje apo si formë, vjen tek artisti, vjen tek poeti, sipas vargjeve të Lasgushit, si FLAKË, si HIJE, si YLL, ... Vjen si flakë kur poeti është i ndërgjegjshëm e arsyeton apo mendon për përmbajtjen e formën e krijimit poetik në fjalë, kur frymëzimi dhe përqëndrimi i vëmendjes është i vetëdijshëm, kur mban shënime, etj. ideja artistike vjen si hije në rastet kur poeti nuk është duke menduar për të, ajo i vjen papritur, në momente festive të gëzuara, në momente hidhërimesh, i vjen kur poeti është në gjëndje dremiteje, i vjen kur është duke kaluar kohën me aktivitete kulturore apo sportive, mund t'i vijë edhe në ëndërr. Ajo vjen kur mund të jetë me temperaturë, mund të jetë në gjëndje të ngacmuar nga alkooli, kur s'është i përgatitur për shënime, mund të vijë nga nënshtresat e pavetëdijes e që gjatë realizimit të poezisë kalon domosdo në vetëdije. Zjarri i Dritës së Përjetësisë e çudit poetin në procesin shkrepëtimtar të krijimit. Më në fund poezia u realizua. Idetë poetike u përpunuan në laboratorin e poetit, u pasuruan

me ide e ndjenja të reja, pasuruan Mbretërinë Qiellore lasgushiane, e arritën lartësinë e saj e, në formë krijimi, si një flakë e re me fërfëllime të ndryshueshme, fillojnë të kullojnë vazhdimisht nga poeti te njerëzit, duke dalë pas torturimit të shpirtit të tij, nën mijëra vargje, që formojnë sistemin e tij poetik.

U çlirua shpirti i poetit nga frymëzimi, shpëtoi nga shkëlqimi i zjarrit të flakërues shkrepëtimtar, u qetësua e, pa drita, pa vezullime, ai, pyet pastaj për verbimin e syve, për nxirrjen e dheut, për errësimin e qiellit e të gjithësisë.

Kjo gjëndje është normale: si flakë, si hije, si yll erdhi frymëzimi te poeti; si flakë e re, si yll i ri del krijimi prej tij; s' djeg më kraharori dhe i gëzuar, poeti sheh vjershën e tij, si nëna e lumtur që çlirohet e gëzohet kur lind fëmijën e saj. Ç'ka hyjnore në këtë krijim? Asgjë! Ku ka misticizëm në këtë proces? Askund! Proçesi i krijimit është real e pasqyrohet realisht në krijimin lasgushian, pa hyjnizime, pa mistifikime.

Gjatë krijimit, frymëzimit e përqëndrimit, bëhet një betejë vërtet e madhe për zgjedhjen e mendimeve aty për aty njëri mendim ia lëshon vendin tjetrit; kushedi sa prej tyre zëvendësohen me të tjerë; të cilët përsëri mund të rizëvendësohen. Pastaj fillon kacafytja e të shprehurit të tyre artistikisht, me efekt të fuqishëm ideoemocional. Për çdo mendim lindin dyshime. E ka radhën shqetësimi i renditjes së mendimeve, krahas renditjes së fjalëve për shprehjen e tyre. Shumë punë kërkohet nëqoftëse lind dyshimi për fjalën e përdorur, nëse ajo është apo nuk është e gjuhës shqipe. Ka raste kur disa mendime, pavarësisht nga nuancat, janë të pranueshme për të njëjtën poezi. Këto janë situatat që e shpien poetin në krijimin e një poezie me disa variante. Del nga zemra një poezi, frymëzimi i së cilës, në formë ylli, nuk dihet nga vjen. Në ç'kuptim nuk dihet? Përmbajtja e frymëzimit nuk dihet kur ka ardhur në atelinë e

poetit, ku ka qënë ai kur ka ardhur ai frymëzim, mënyra si ka ardhur, sa herë ka ardhur, ka ardhur njëherësh apo pjesë-pjesë, ka ardhur si flakë apo si hije, etj.

Duke u mbështetur në literaturën e huaj, në të gjitha tekstet e artit dhe të letërsisë, është shprehur mendimi, sipas të cilit këto e pasqyrojnë realitetin, idenë, subjektin, përmbajtjen e temës me figura artistike, me figura letrare, me figura poetike.

Që kur kam qënë i ri, gjimnazist, Lasgushi më ka sqaruar se përmbajtja shkencore e figurës poetike, tek ne nuk është kuptuar, është keqkuptuar, ka mbetur plotësisht e panjohur. Deri tani në moshën 76-vjeçare, edhe unë nuk kam gjetur shembuj për ta kundërshtuar këtë pohim të Lasgushit. Për të kuptuar kategorinë e figurës poetike, është e domosdoshme që idenë, subjektin, temën apo përmbajtjen e poezisë, ta shprehim me gjuhë të zakonshme popullore, në mënyrë të natyrshme, si komunikim i zakonshëm midis njerëzve, pastaj ta shprehim me figurë poetike, përmbajtjen e përkufizimit të së cilës po e japim më poshtë: idenë, subjektin apo temën e poezisë së tij poeti nuk e jep duke fotografuar realitetin, por duke e pasuruar dhe transformuar atë fuqimisht me shpirtin e tij, me fjalët e komunikimit të natyrshëm dhe me të tjera, me më shumë ose më pak fjalë se komunikimi i zakonshëm popullor, me shumë kërkesa artistike, sintaksore e gramatikore, me kërkesat e teorisë së letërsisë e metrikës, në vargjet e poezisë duhet të vallëzojë harmonia, melodia, muzikaliteti, dhe ritmi artistik, me figura stilistike, me trope apo translate të përsosura në kuptimin sasior e cilësor, etj. etj.

Ilustrimi për kuptimin e figurës poetike, është realizuar në kapitullin XI të librit "Ringjallet Rilindja e Lasgushit", nëpërmjet disa poezive të veprës "Dehje Poradecare" të poetit Maksut Çallo.

Petro Prifti

Pogradec, 25 shtator 2009

Ushqyerja me gji e fëmijës është një privilegj për bebin, por edhe për nënën e tij. Kjo ndodh për disa arsye, që do t'i shtjellojmë më poshtë.

Ndikimi në sferën psikologjike

Nga ana psikologjike ky akt sublim ka një efekt të ndërsjelltë afiniteti midis këtyre dy protagonistëve me njëri-tjetrin. Vërtet që universi intim midis nënës dhe fëmijës zë fill qysh kur nëna mendon për shtatzaninë, por nuk ka gjumë të mrekullueshëm kur sheh që krijesa jote ushqehet me të vetmin ushqim të ardhur nga trupi yt. Një shprehje e bukur thotë: “Nëna di të ofrojë gjirin, i porsalinduri di ta thithë atë, përshtatja është diçka instinktive.” E gjithë kjo ngre në një shkallë të lartë dashurinë e nënës për fëmijën e saj.

Nga ana tjetër, fëmija duke ardhur nga brendësia e trupit të nënës së tij, është mësuar me ngrohtësinë, zërin, madje edhe me aromën e nënës së tij. Për këtë arsye, fëmija i duhet vënë sa më parë nënës në kraharorin e saj pas lindjes. Kjo gjë do të krijonte sigurinë dhe do të shtonte qetësinë e bebit.

Shumë nëna kanë ankthin se a do të kenë qumështin e mjaftueshëm për të ushqyer fëmijën e tyre. Pa asnjë shqetësim. Marrëdhëniet në këtë drejtim janë me të vërtetë marrëdhënie kërkesë-ofertë. E thënë më thjesht, sa më shumë të kërkojë fëmija për të pirë, aq më shpesh do ta vini atë në gji, aq më shumë trupi juaj do të prodhojë qumësht.

Edhe dy gjëra për të sqaruar; e para, nuk ka rëndësi nëse keni gjinj të vegjël apo të mëdhenj, qumështi prodhohet njëlloj, e dyta, mos nguroni të ushqeni fëmijën edhe natën, me paramendimin se do t'ju prishë gjumin.



Qumështi i nënës dhe medikamenti më i mirë

Përkundrazi, natën prolaktina që është përgjegjëse për prodhimin e qumështit, prodhohet më me shumicë. Nga ana tjetër, kur të shihni e fëmijën do ta zërë gjumi të kënaqur, krijon një relaks në trurin tuaj dhe gjumi do t'ju zërë lehtësisht.

Qumështi si ushqim i pazëvendësueshëm

Si ushqim qumështi i nënës është më i miri dhe më i pazëvendësueshmi, pasi është i pasur me të gjitha çka i duhen të prosalindurit për të filluar jetën e tij, madje derisa të bëhet 6 muaj. Ai përmban proteinat aq të nevojshme për rritjen e fëmijës, përmban laktozë dhe yndyrna të nevojshme për t'i dhënë kalori fëmijës, përmban ujë dhe vitamina aq të nevojshme për shëndetin e tij, përmban fermente aq të

nevojshme për të ndihmuar përthithjen në zorrë dhe për një jashtëqitje të rregullt. Të gjitha këto në sasinë dhe cilësinë e duhur për t'u përthithur nga aparati tretës i fëmijës. Mos harroni se kjo përshtatshmëri i dedikohet prejardhjes nga e njëjta specie.

Qumështi si medikament

Pra themi se qumështi i nënës është edhe një medikament për fëmijën, madje do të thosha një medikament gati universal dhe parandalues.

Qumështi i nënës përmban leukocite të gatshme të nënës, që e mbrojnë fëmijën nga ndonjë infeksion akut i mundshëm, përmban imunoglobulina që krijojnë një imunitet artificial për shumë sëmundje, derisa fëmija të krijojë imunitetin e vet, përmban

hekur të një cilësie të tillë, lehtësisht të asimilueshëm nga aparati tretës i fëmijës, gjithashtu dhe laktoferrinën, që bën lidhjen e hekurit gati për t'u përthithur dhe nga ana tjetër pengon rritjen në zorrët e bebit të disa bakterieve të dëmshëm, por që kanë nevojë për hekur për zhvillimin e tyre.

Pra siç nënkuptohet, një fëmijë që ushqehet me gji, do të jetë më i mbrojtur nga sëmundjet, më i shëndetshëm dhe më i zhvilluar nga ana psiko-motore.

Së fundi, dua të theksoj se fëmijët që ushqehen me gji, sëmuren më pak nga infeksionet e veshit të mesëm, pasi gjatë aktit të thithjes dhe të gëlltitjes, ata i bëjnë një ajrosje, “fiskulturë” tubit të Eustakut, që lidh fytin me veshin e mesëm. Duke mbetur përsëri në këtë temë, ushqimi me gji i fëmijës, parandalon një sërë sëmundjesh tek nëna. Vënia sa më herët që të jetë e mundur e fëmijës në gji bën që të prodhohet në sasinë e duhur oksitocina, e cila detyron uterusin të shkojë në përmasat e tij normale dhe kështu realizohet nxjerrja lehtësisht dhe pa hemoragji të tepruar e placentës. Prodhimi i qumështit më pas do të stimulohet nga prolaktina, e cila duke u sekretuar vazhdimisht, do të reduktojë peshën trupore të nënës, deri në ato të paralindjes.

Gjithashtu nga studimet e fundit është arritur përfundimi se ato nëna që ushqejnë fëmijët e tyre me gji, preken ma pak nga kanceri i gjirit dhe i vezoreve.

Në përfundim dua t'u bëj një apel atyre nënave “moderne” që për hir të mosprishjes së linjave të tyre, nuk i ushqejnë fëmijët me gji: Përveçse shkelni të drejtën legjitime dhe të Zotit, që fëmija juaj të ushqehet me gjirin e nënës së tij, ju krijoni një ftohtësi me fëmijën, gjithashtu dëmtoni veten tuaj, duke ndërprerë në mënyrë brutale dhe të pakuptimtë lojën hormonale që natyrshëm ndodh në këtë kohë në trupin tuaj.

Dr.Andrea Kocaqi

Mjek familjeje, ambulanca Libonik, Korçë

Horoskopi javor i "Nositit"



Dashi (21.3-20.4)

Edhe pse do të punoni shumë, sërish nuk do të keni rezultatet e dëshiruara menjëherë.

Demi (21.4-20.5)



Mund të hyni në marrëveshje të rëndësishme pune, nga të cilat do të jeni të fituar.

Binjakët (21.5-21.6)



Do të mendoni për të ardhmen bashkë me shokët apo familjarët tuaj, megjithëse ka ndryshim.



Gaforrja (22.6-22.7)

Gjatë javës do të ndiheni mjaft në formë, me shumë vitalitet dhe dëshirë për të vepruar.

Luani (23.7-23.8)



Duhet të vini në punë intuitën tuaj dhe të merrni mirë parasysh këshillat e të afërmeve.

Virgjëresha (24.8-23.9)



Mund të vihni përballë një takimi që do të shoqërohet me emocione të mëdha. Kujdes në punë.



Peshorja (24.9-22.10)

Duhet të merrni patjetër një vendim për të shpënë deri në fund punët e lëna përgjysëm.

Akrepi (23.10-22.11)



Do të keni rastin tuaj më të mirë për t'u afirmuar tek personat që ju rrethojnë e ju vlerësojnë.

Shigjetari (23.11-22.12)



Duhet të përdorni mirë qetësinë tuaj për të bërë më të lehtë vendimin që duhet të merrni.

Bricjapi (23.12-20.1)



Më në fund do të arrini qetësinë e dëshiruar. Duhet të përmirësoni më shumë dialogun.

Ujori (21.1-19.2)



Një takim i papritur do të krijojë tërmetin për ju. Do të ngatërmoni problemet e lëna pas.

Peshqit (20.2-20.03)



Situata ekonomike do të vijë duke u përmirësuar, por duhet të bëni shumë kujdes në kontratat.



Policët në një postbllok

Policët ndalojnë një grua në një postbllok: "A nuk e dini ju zonjë se është e ndaluar të mbani qentë në makinë?"

"Jo more, është prej pelushi!"

"Nuk të pyeti kush për racën!"

Gjirokastriti dhe aksidenti

Ka ndodhur një aksident, njolla gjaku përdhe, makinat janë përplasur; kalon një gjirokastrit dhe pyet.

-A ka ardhur siguracioni?

-Jo.

-A ka mundësi të shtrihem edhe unë?

Polici dhe ora

Një polic po hulumtonte me shumë kujdes një orë dore. E kthen para mbrapa vazhdimisht. Një koleg bëhet kurioz dhe e pyet:

-Çfarë po bën???

-E dashura ime më dhuroi këtë orë dhe më tha se edhe mund të lahem me të.

-Eh pastaj, çfarë gjëje të jashtzakonshme ka këtu?

-Duket se ia kanë hedhur, ka gjysmë ore që po e shoh dhe s'po e gjej se ku e ka rubinetin...



Vipat Top Sekret

Vogëlushi 5-vjeçar Giuliano Stroe nga Rumania mahnit botën

(Ende pa u bërë 6 vjet ai hyn në Librin Ginnes)

Vogëlushi Giuliano Stroe, i cili ende s'ka mbushur 6 vjet, ka hyrë në



Librin Gines të Rekordeve Botërore. Stroe hyn në këtë libër ende pa ditur ta lexojë atë. Edhe pse është shumë e pazakonshme për një fëmijë të moshës së tij Giuliano është stërvitur vazhdimisht dhe është filmuar nga babai i tij

duke demonstruar ushtrime të shumta gjimnastikore që nga saltrot, vertikale, pompa, ushtrime në paralele (të gjitha këto shikohen në vidion e tij në youtube). Për të palestër ka qënë shtëpia e tij, tavolina, karriget dhe disa paralele të vendosura në dhomën e gjumit apo të fiksuara në mur. Në datën 26 tetor Stroe për 24 sekonda ka përshtuar distancën prej 10 metër i ngritur në vertikale me dy duar duke mbajtur një top në mes të këmbëve. Ky lloj ushtrimi për shkak të specifikës së tij impresionuese ka bërë që vogëlushi të hyjë në librin Ginnes të Rekordeve Botërore dhe në kraharorin e tij të vogël të varet medalja. Pas çdo përfundimi të ushtrimit ai demonstroi "muskujt" e tij në pozicionet e Sylvester Stallone.

Romeo Beckham, do bëhet stilist

Romeo Beckham ka një pasion:
të bëhet stilist si e ëma Victoria

Djali i një prej çifteve më të famshëm në botë, Victoria dhe David Beckham është vetëm shtatë

vjeç dhe e ka një ëndërr të vetme, të krijojë veshje. "Ishim për darkë jashtë, mbrëmë - tha gruaja e Davidit - Romeo kishte veshur një kostum me kemishë dhe kravatë, por kjo është çfarë do të kishte zgjedhur në çfarëdo rasti tjetër: e do modën. Fëmijët e tjerë Brooklyn (10 vjeç) e Cruz (4 vjeç),



mendojnë sesi ta kalojnë kohën në plazh duke luajtur, por ai jo, nuk është i interesuar. "Dua të punoj me mamën", - thotë dhe vjen në ateliein tim, rri me orë të tëra duke parë stofrat, i zgjedh dhe më jep mendimin e tij. Ai e adhuron punën si stilist".



Libra të rinj nga

"D.I.J.A.-PORADECI"



Ilir SHYTA

LASGUSH PORADECI Bibliografi e arsyetuar



"Lasgush Poradeci, Bibliografi e arsyetuar", nga Ilir Shyta, mund t'ju shërbejë atyre që merren me krijimtarinë e Lasgushit, veçanërisht mësuesve të letërsisë dhe nxënësve, që e studjojnë poetin në shkollat e të gjitha niveleve. Ajo do t'ju vlente më së shumti studentëve të degës Gjuhë-Letërsi, por edhe lexuesve të zakonshëm, të cilët do të merrnin një informacion përmbledhës, për veprën letrare të Lasgush Poradecit apo të mund të përjetonin emocionet e ndonjë leximi të mëparshëm, të poezive të poetit. Botimi është një përpjekje, për të paraqitur në një vëllim të vetëm, në mënyre sintetike, madhështinë e gjithë veprës lasgushiane.-

Horizontalisht: 1.Malet... në Rumani 6.Sergej..., poet rus 11.Inicialet e Moisiut 12.Këngëtarja Take, inicialet 13.Shkrimtari Zola 15.Autori i romanit "Stina e armëve" 17.Patrioti Boletini, inicialet 18.Inicialet e shkrimtarit gjerman Man 19.Përemër vektor 20.Eshtë figurë gjeometrike 24.Humoristi Banushi 26.Fransua..., ka qenë president i Francës 28.Shkruhet për të xhiruar filmin 30.Eshtë sport ujqor 33.Lloj muzike vallëzimi 35.Korça në makina 36.Ekip futbollit i Budapestit 39.Si nr.11 41.Notë muzikore 42.Nxirren në... për t'u shitur mallrat e konfiskuara 45.Spanja në tabelat elektronike 47.Emër kinezi 48.Inicialet e këngëtares Dilo 49.Një perandor romak i njohur 50.Shteti afrikan... i Fildishtë 51.Quhen komandantët e kozakëve 53.Rafaela... e RAI-t 55.Republika Popullore e Kinës 56.Aleko..., humorist 57.Eshtë mjet mësimor gjeografik

Vertikalisht: 1.Mund të jetë një oficer 2.Organizëm ujor njëqelizor 3.Njëri nga muskëterët e Dymasë 4.Një grimcë me bërthamë 5...Pashë Toptani 7.Hidhet... për të përcaktuar çiftet që ndeshen 8.Eshtë gjarpër 9.Notë muzikore (në invers) 10.Nikeli në tabelë 14.Çu En... 16.Kërkohet nga poetët 21.Notë muzikore 22.Gjysmë tapë 23.Hani pa zë 25.Ka kryeqytet Katmandu 27.Ka kryeqytet Dublin 29.Këngëtarit italian Modunjo 31.Inicialet e portierit gjerman Kahn 32.Ekip moskovit futbollit 33.Ia vuri kufirin te... 34.Gjysmë gare 37.Mund të jetë memece 38.Inicialet e ish futbollistit vlonjat Kushta 40.Gjeti... ose shkak 43.Një pikë ligji 44.Gjitar me brirë të degëzuar 46.Targa e një qyteti bregdetar 47.Emri i këngëtarit italian Barbarosa 51.Medalja e të parit 52.Eshtë Melesini 54.Inicialet e Nevskit

1	2		3	4		5		6	7		8	9	10	
11			12								13			14
15							16							
17			18			19			20	21		22	23	
24					25		26	27						
														29
30	31	32								33			34	
	35			36			37		38				39	
40		41					42				43	44		
45	46			47			48			49				
50						51			52					
				53	54							55		
56									57					

Përgjigjet e fjalëkryqit të numrit të kaluar (Nr. 467)

Horizontalisht: 1.Etiopia 6.Kruja 10.Do 11.Ovula 13.Sa 14.ML 15.Iliada 17.Lushnja 18.Ta 19.KO 20.Dasma e Figaros 25.Polen 26.Kos 27.IK 29.In 30.Dushku 32.Mmr 33.Dajja 34.Ema 35.Saga 36.Do 37.Katil 38.Top 39.En 40.Ura 42.Katari 45.Rit 46.Ariu 48.Ura 49.AK 50.Adil 51.Starti 53.Alma 54.Papa 55.EL

Vertikalisht: 1.Edi 2.Toledo 3.Pod 4.Ivana 5.Au 6.Kau 7.Ushta 8.Janari 9.Al 12.Llafoset 14.Maksim Gorki 16.Arseniku 21.Alia 22.Mn 23.Eku 24.Ishmi 25.Po 28.Krapi 30.Dakari 31.kalkuta 32.Mata 33.Donika 36.Dera 41.Rada 43.Ara 44.Tare 47.ILP 50.AM 51.SP 52.TL

Botues: Ilir DUKA & Afroviti GUSHO
Në kompjuter: Edlir PODA
Lexoni gazetën në: www.poradeci.com
Gazeta shpërndahet në Qarkun Korçë

Enti Botues: "D.I.J.A. Poradeci", -Pogradec
Adresa e Redaksisë: Rruga "Rinia", Pallatet 7-katësh, Pogradec
Tel: +355 832 2905, **Mobil:** 069 2143753
e-mail: afrovitig@yahoo.com;
 redaksianositi@yahoo.com